

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS



PLANI STRATEGJIK 2021 – 2025

PRISHTINË, 2021



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency

PLANI STRATEGJIK

2021-2025

Prishtinë, 2021

PËRMBAJTJA

FJALA E DREJTORIT EKZEKUTIV	9
SHKURTESAT.....	12
1. PARATHËNIE	15
2. HYRJE.....	16
3. AVANSIMI DHE SFIDAT E AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS.....	18
4. NDIKIMET E PRIORITETEVE DHE STRATEGJIVE TË QEVERISË	21
5. KORNIZA LIGJORE DHE ORGANIZIMI I KADASTRIT	23
5.1. Korniza ligjore	23
5.2. Organizimi aktual i AKK-së	26
5.3. Zyrat kadastrale komunale.....	28
6. KORNIZA INSTITUCIONALE.....	29
6.1. Komiteti ndërministror për administrim të tokës dhe infrastrukturë kombëtare të informacionit hapësinor.....	29
6.2. Komiteti koordinues me donatorët.....	30
6.3. Organizimi vertikal i kadastrit	31
6.3.1. Autonomia udhëheqëse e Agjencisë Kadastrale të Kosovës.....	31
6.3.2. Roli i ZKK-ve në reformën kadastrale	34
6.3.3. Gjeodetët dhe kompanitë e licencuara gjeodete	37
6.3.4. Bashkëpunimi me Shoqatën – Odën e Gjeodetëve	38
6.4. COVID 19	39
7. ZHVILLIMET E ADMINISTRIMIT TË TOKËS	40
7.1. Zhvillimet Evropiane	40

7.1.1. Iniciativa Evropiane – INSPIRE.....	42
7.1.2. Infrastruktura Kombëtare e Informacioneve Hapësinore në Kosovë (IKIH).....	43
7.1.3. Përdorimi i informatave nga sektorë të ndryshëm	46
7.1.4. Zhvillimet në administrimin e tokës në Evropë	46
7.2. Zhvillimet teknologjike të cilat i referohen administrimit të tokës	47
7.2.1. Integrimi i të dhënave.....	48
7.2.2. Përkrahja e TIK-ut për proceset e administrimit të tokës	48
7.2.3. Standardet e hapura	51
7.3. Ngritja e kapaciteteve.....	52
8. PROCESET E ADMINISTRIMIT TË TOKËS NË AKK	54
8.1. Reforma ligjore	54
8.2. Zhvillimi dhe modernizimi i kadastrit.....	55
8.3. Punët themelore gjeodezike.....	56
8.4. Teknologjia e Informacionit dhe Infrastruktura Gjeohapësinore	56
8.5. Ri-organizimi i kadastrit dhe vetë-financimi	57
8.6. E-Qeverisja.....	58
8.7. Ndërtimi i kapaciteteve	59
8.8. Menaxhimi i burimeve njerëzore.....	60
8.9. Zhvillimi i produkteve dhe inovacioni (Orientimi drejt konsumatorit)	61
8.10. Menaxhimi i cilësisë	61
8.11. Çështjet e ndërlidhura	62
8.11.1. Masat kundër korrupsionit.....	62
8.11.2. Barazia gjinore dhe të drejtat e minoriteteve	63

9. PLANI FINANCIAR.....	64
9.1. Vlerësimi i kostove dhe financimi i tanishëm	64
9.1.1. Buxheti i AKK-së për vitin 2020.....	64
9.1.2. Shpenzimet e AKK-së	65
9.1.3. Analizimi i pagave dhe mëditjeve.....	66
9.1.4. Të hyrat e AKK-së.....	67
9.1.5. Mundësitë (opcionet) e financimit në të ardhmen	69
10. STATISTIKAT.....	71
10.1. Statistika nga SIKTK.....	71
10.2. Statistika nga RIK dhe KN	74
11. PËRMBLEDHJE	76
SHTOJCA 1:.....	79
1. ANALIZIMI I BUXHETIT TË AKK-SË DHE ZKK-VE	79
1.1. Analiza e të ardhurave, kostos operative dhe përmbledhja e investimeve në AKK dhe ZKK.....	81
1.2. Analizë e buxhetit paraprak të AKK-së.....	82
1.3. Analizimi i shpenzimeve dhe të hyrave sipas viteve	84
1.4. Zyrrat Kadastrale Komunale.....	85
2. PARASHIKIMI I TË HYRAVE PËR ZKK.....	86
3. PARASHIKIMI I BUXHETIT TË AKK-SË PËR 5 VITET E ARDHSME 2020-2024.....	90
4. PARASHIKIMI I BUXHETIT 2020-2024 SË BASHKU ME ZKK-TË.....	92
REFERENCAT.....	95

Tabela 1. Buxheti i AKK-së nga granti qeveritar	64
Tabela 2. Buxheti i AKK-së nga klauzola e investimeve.....	64
Tabela 3. Pasqyra e shpenzimeve të AKK sipas viteve (të shprehura në euro).....	65
Tabela 4. Paga dhe mëditje 2013-2018 (të shprehura në euro).....	66
Tabela 5. Të hyrat jo tatimore (të shprehura në euro)	67
Tabela 6. Të hyrat nga donatorët.....	67
Tabela 7. Të hyrat nga huamarrja	68
Tabela 8. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2019 nga 15 ZKK	69
Tabela 9. Buxheti i AKK-së për 5 vite (të shprehura në euro)	82
Tabela 10. Përqindja e rritjes sipas viteve - nga viti në vit.....	83
Tabela 11. Numri i punëtorëve, shpenzimet për paga dhe të hyrat për vitin 2018 në ZKK-të	87
Tabela 12. Planifikimi për drejtoritë e kadastrit nëpër komuna për shpenzimet për paga dhe mëditje sipas KAB 2020-2022.....	88
Tabela 13. Planifikimi i të hyrave vetanake në kuadër të KAB 2020-2022 të komunave.....	89
Tabela 14. Parashikimi i të hyrave vetanake në ZKK-të 2021-2025.....	89
Tabela 15. Parashikimi i buxhetit për 5 vitet e ardhshme për AKK-në (të shprehura në euro)	90
Tabela 16. Parashikimi i buxhetit 2021-2025 duke përfshirë ZKK-të (të shprehura në euro)	92

Figura 1. Organogrami i AKK-së (Burimi: Rregullore e brendshme e AKK-së nr.20/2014).....	27
Figura 2. Trendi i rritjes së shpenzimeve për paga dhe mëditje 2014-18.....	66
Figura 3. Të hyrat nga donatorët 2013-2018.....	68
Figura 4. Buxheti i AKK-së për 5 vitet e fundit.....	83
Figura 5. Trendi i rritjes nga viti në vit i buxhetit të AAK-së	84
Figura 6. Dallimi në mes të hyrave dhe shpenzimeve të AKK-së 2021-2025	93
Figura 7. Krahasoni i të hyrave dhe shpenzimeve të AKK së bashku me ZKK-të por pa i përfshirë Investimet kapitale	94
Figura 8. Krahasoni i të hyrave dhe shpenzimeve të AKK së bashku me ZKK-të duke i përfshirë Investimet kapitale.....	94

FJALA E DREJTORIT EKZEKUTIV

Agjencia Kadastrale e Kosovës, autoriteti qendror për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave kadastrale, për mirëmbajtjen e regjistrave pronësorë, për hartogra dhe GIS, për sistemin e unikuar të adresave, për infrastrukturën kombëtare të informacioneve hapësinore dhe për administrimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit vitin që lamë pas shënoi 20 vjetorin e themelimit



Përgjatë këtyre dy dekadave, respektivisht pas rimëkëmbjes sfiduese të pasluftës, me gjithë përfshirjen e institucioneve vendore e ndërkombëtare, ekspertëve vendor e ndërkombëtar, është arritur të ndërtohet një institucion autoritativ që prodhon të dhëna e shërbime të sakta, të besueshme e të shfrytëzueshme nga secili institucion e individ, brenda e jashtë Republikës së Kosovës.

Kjo është arritur falë ndërtimit të kapaciteteve njerëzore e teknologjike dhe falë gjithëpërfshirjes profesionale e shoqërore, trende këto pozitive ndjekja e të cilave është reflektuar e rekomanduar edhe në Planin Strategjik 2021-2025 dhe Planin e Biznesit dhe Veprimit 2021-2023+.

Ndërsa sot si asnjëherë më parë, Agjencia Kadastrale e Kosovës është e sfiduar në realizimin e objektivave të përcaktuara në zhvillimin dhe realizimin e vizionit të saj për një kadastër të avancuar në kontekstin e cilësisë, sasisë, efikasitetit të të dhënave kadastrale nga shfrytëzimi i të cilave edhe kënaqshmëria e përdoruesve do të ishte në nivelin sa më të lartë të mundshëm.

Si sfidë e parë është korniza ligjore në kuadër të së cilës, edhe pas reformave të shumta të ndërmarra sidomos dy viteve të fundit, pamundësohet realizimi i

tërësishëm i vizionit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Një ligj i ri për kadastrë, në linjë me Strategjinë Qeveritare për të Drejta Pronësore si përgjigje ndaj shumë sfidave, tani më është draftuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, dhe është në pritje të aprovimit të tij nga Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës. Në rast të aprovimit të këtij Ligji, lehtësohet edhe implementimi i Planit Strategjik 2021-2025 dhe Planit të Biznesit dhe Veprimit 2021-2023+.

Si sfidë e dytë është Covid19 e cila nga OBSH-ja është shpallë si pandemi e nivelit botëror. Kjo sfidë po imponon ndryshim të strategjive dhe formave të funksionimit dhe komunikimit, si rrjedhojë edhe e planifikimit të koncepteve ndërvepruese në fushën e krijimit të gjeoinformacioneve, të dhënave kadastrale dhe shërbimeve për përdoruesit, si që janë qytetarët, bizneset, institucionet e ndryshme vendore e ndërkombëtare.

Plani Strategjik 2021-2025 dhe Plani i Biznesit dhe Veprimit 2021-2023+ mundësojnë tejkalimin e këtyre dy sfidave dhe vendosjen e koncepteve ligjore, teknologjike dhe njerëzore, që do të rezultojnë me rreshtimin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës në po të njëjtin nivel me vendet e zhvilluara Evropiane.

Duhet potencuar se Plani Strategjik 2021-2025 dhe Plani i Biznesit dhe i Veprimit 2021-2023+ nuk janë dokumente të shkëputura e të vetme. Për më shumë ato reflektojnë edhe reformat ligjore të cilat Agjencia Kadastrale e Kosovës i kishte filluar gjatë vitit 2019, të cilat vazhduan edhe gjatë vitit 2020 me nxjerrjen e dhjetëra udhëzimeve të reja administrative në fushën e kadastrës, pronës dhe sistemit të adresave dhe dokumentacionit profesional e teknik që Agjencia Kadastrale e Kosovës i kishte publikuar dy viteve të kaluara si: Doracakun për Kadastrin e Ndërtesave, Doracakun për Rindërtimin e Informacioneve Kadastrale, Doracakun për Sistemin e Adresave, Udhëzuesin për Procedurat e Regjistrimit të Pronës, Kornizën e Punës për Matjen, Krijimin dhe Regjistrimin e Njërive Kadastrale.

Këto dokumente plotësojnë njëra tjetrën si koncepte të planifikuara të organizimit dhe krijojnë mundësi më të mëdha në ndërtimin dhe ngritjen e kapaciteteve zhvillimore, teknologjinë e informacionit dhe infrastrukturën gjeohapësinore si dhe modernizimin e kadastrit.

Për fund duhet thënë se Plani Strategjik 2021-2025 dhe Plani i Biznesit dhe i Veprimit 2021-2023+, krijojnë mundësi bashkëpunimi dhe monitorimi të aktiviteteve kadastrale, krijojnë siguri më të madhe të të drejtave të pronës së paluajtshme, parashohin zbatimin e konventave dhe direktivave për të drejtat e njeriut, me theks të veçantë të drejtat e grupeve potencialisht të marginalizuara etj.

Dokumenti në vijim është dokument dinamik dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës do të bëjë azhurnimin e të njëjtit, varësisht nevojave të saja dhe të grupeve të ndryshme të interesit.

Me respekt,

Avni Ahmeti

Drejtor Ekzekutiv

SHKURTESAT

PS	Plani Strategjik
PBV	Plani i Biznesit dhe i Veprimit
AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
SIKTK	Sistemit Informativ Kadastral për Tokën në Kosovë
IKIH	Infrastruktura Kombëtare e Informacionit Hapësinor
ZKK	Zyrave Kadastrale Komunale
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
RDPP	Regjistri për të Drejtat në Pronën e Paluajtshme
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
REGIP	Projekti për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme dhe Infrastrukturë Gjeo-Hapësinore
KEE-KB	Komisioni Ekonomik për Evropën e Kombeve të Bashkuara
INSPIRE	Infrastruktura për Informacion Hapësinor në Evropë
SI	Sistemi Informativ
TI	Teknologji Informative
ONS	Organizata Ndërkombëtare për Standardizim
BE	Bashkimi Evropian
SIG	Sistemet e Informacionit Gjeografikë
KHG	Konsorciumi i Hapur Gjeo-Hapësinorë
MP	Marrëdhëniet me Publikun
GP	Grupi Punues
ARIS	Aplikacionin për informacione të sistemit të adresave

MDAT	Modeli i Domenit të Administrimit të Tokës
OUB	Organizatrat për Ushqim dhe Bujqësi e Kombeve të Bashkuara
MIA	Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit
MEA	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
KOPOS	Kosovo Positioning System - Sistemi i Pozicionimit në Kosovë
SSNG	Sistemit Satelitor i Navigacionit Global
TQM	Total Quality Management – Menaxhimi Total i Kualitetit
BIM	Building Information Modeling – Ndërtimi i Modelimit të Informacionit

1. PARATHËNIE

Plani Strategjik 2021-2025 dhe Plani i Biznesit dhe i Veprimit 2021-2023+, janë bazuar në strategjinë e zhvillimit 2013- 2017 të Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), duke ofruar veprime të detajuara për zhvillimin e AKK-së dhe sektorin e administrimit të tokës. Kjo Strategji mbulon periudhën kalendarike 2021-2025. Plani Strategjik 2021-2025 dhe Plani i Biznesit dhe i Veprimit 2021-2023+, trajtojnë çështje të rëndësishme që mbesin për tu zgjidhur, duke vënë theksin në objektivat strategjik si njërin prej synimeve kryesore. Vendosija e proceseve të administrimit të tokës që funksionojnë mirë në infrastrukturën ekonomike dhe shoqërore të Kosovës është çështja kyçe e kësaj Strategjie dhe Planit të Biznesit.

Pasi fusha e administrimit të tokës është në zhvillim të shpejtë, Plani Strategjik dhe Plani i Biznesit dhe i Veprimit, merr parasysh këto zhvillime të reja në shoqëri dhe mjedisin regjional, evropian, ndërkombëtar të cilat kanë ndikim në nevojën e shoqërisë për mbrojtje të të drejtave pronësore, shërbime kadastrale efikase dhe të informatave të sakta për pronën e paluajtshme. Për këtë arsye, Plani Strategjik 2021-2025 dhe Plani i Biznesit dhe i Veprimit 2021-2023+, pjesërisht janë bazuar në analiza të jashtme që përfshijnë zhvillime regjionale, evropiane dhe ndërkombëtare të administrimit të tokës.

Implementimi i Planit Strategjik 2021-2025 dhe Planit të Biznesit dhe të Veprimit 2021-2023+, kërkon përkrahje nga Qeveria e Republikës së Kosovës në promovimin dhe vendim-marrjen për një numër të çështjeve të specifikuar në këtë dokument, sidomos sa i përket aranzhimeve institucionale dhe financimit të aktiviteteve dhe zhvillimeve. Këto dokumente propozohet t'i dorëzohen Qeverisë për miratim, dhe me kërkesën për vendim marrje të Qeverisë mbi çështjet e specifikuar në këtë dokument.

Për më tepër, përkrahja e donatorëve do të jetë e nevojshme për kompletimin e disa aktiviteteve dhe zhvillimeve për reformën e mëtutjeshme të sektorit të administrimit të tokës dhe profesionalizimin e institucioneve të përfshira.

2. HYRJE

Plani Strategjik 2021-2025 dhe Plani i Biznesit dhe i Veprimit 2021-2023+, japin një përmbledhje të gjendjes aktuale, një strategji të azhurnuar dhe një plan biznesi / veprimi të detajuar për zhvillimin e AKK-së dhe sektorit të administrimit të tokës në Kosovë. Ky Plan Strategjik mbulon një periudhë 5 vjeçare - periudhën kalendarike 2021-2025, kurse Plani i Biznesit dhe i Veprimit mbulon periudhën 2021 -2023+, dhe përfshin vlerësimet e kostove për aktivitetet e parashikuara dhe propozimet në lidhje me financimin.

Gjatë periudhës së kaluar janë marrë vendime në lidhje me aranzhimet ligjore dhe institucionale për administrimin e tokës dhe Infrastrukturën Kombëtare për Informacione Hapësinore (IKIH), ku këto iniciativa duhen vazhduar edhe më tutje. Siguria e pronësisë dhe kujdesi adekuat dhe i barabartë për pronarët janë pikat kryesore në zhvillimin e shërbimeve të administrimit të tokës. Duhet kushtuar vëmendjen edhe zhvillimeve të reja, për shembull futja në përdorim e e-qeverisjes në administratën publike dhe konceptet e infrastrukturës për informacione hapësinore në linjë me Direktivën INSPIRE të BE-së.

Plani Strategjik 2021-2025 përmbledh identifikimin e formave të qasjes dhe kontributit në përmirësimin e çështjeve të qeverisjes së mirë, si që janë transparenca dhe llogaridhënia, duke përmirësuar strukturën institucionale të AKK-së dhe ZKK-ve.

Plani Strategjik 2021-2025 parasheh propozime në zhvillimin gradual të detyrave dhe përgjegjësiive relevante të ZKK-ve në AKK, që të avancohen përgjegjësitë për të gjitha proceset e mirëmbajtjes së kadastrit gjatë vitit 2021. Kjo përfshinë ndryshimet e mundshme në legjislacion, qeverisje dhe rregullime organizative, pozita të stafit dhe ristrukturimin e Zyrave Kadastrale Komunale.

Çështje kyçe për AKK-në mbetet të jenë: zhvillimi i mëtutjeshëm i kadastrit, politikë

bërja, legjislacioni, definimi i proceseve të biznesit, menaxhimi i resurseve, ngitja e vetëdijes së konsumatorëve/përdoruesve dhe bashkëpunimi me të gjitha palët e interesuara të përfshira. Programi zhvillimor i prezantuar përmban programin e aktiviteteve për periudhën e planifikimit.

Plani strategjik dhe plani i aktiviteteve do të azhurnohet në bazë vjetore. Janë identifikuar njëzet e katër (24) objektivat e ardhshme operationale, të ndërlidhura në katër Objektiva Strategjike të cilat janë elaboruar në kuadër të Planit të Biznesit / Veprimit të këtij dokumenti:

Objektivi Strategjik A - Reforma ligjore (Zhvillimi i politikave dhe korniza ligjore, Zhvillimi institucional, E-qeverisja, Qeverisja e brendshme)

Objektivi Strategjik B - Modernizimi i kadastrit (RIK-u dhe regjistrimi sistematik i të Drejtave të Pronës së Paluajtëshme, Përmirsimi i kualitetit të të dhënave kadastrale, Zhvillimi i kadastrit të përvojave, Zhvillimi i regjistrimit të ndërtesave, Renovimi dhe ri-inzhinjerimi i Zyrave Kadastrale Komunale, Produktet e reja)

Objektivi Strategjik C - Teknologjia e Informacionit dhe Infrastruktura Gjeohapësinore (Përmirsimi i informacioneve kadastrale për tokën në drejtim të Arkitekture së Orientuar në Shërbime (SIKTK-SOA), Arkivi digjital i AKK-së, Strategjia e IT-së për AKK-në, Investimet në IKIH, Zhvillimi i Gjeoportalit, Gjeoinformacioni, Sistemi i Adresave, Sektori privat - roli dhe kontributi, Zhvillimi i rrjetit shtetëror gjeodezik (GPS, KOPOS, Nivelimi dhe Gravimetria), Vlerësimi masiv i Pronës së Paluajtëshme)

Objektivi Strategjik D - Ndërtimi i kapaciteteve (Zhvillimi i burimeve njerëzore, Menaxhimi i projekteve, Informimi publik, Monitorimi dhe Vlerësimi, Promovimi i barazisë gjinore në të drejtat pronësore)

3. AVANSIMI DHE SFIDAT E AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) financohet nga Qeveria e Kosovës përmes Buxhetit të aprovuar të Kosovës. Zyrrat Kadastrale Komunale (ZKK) janë pjesë e organizimit komunal dhe financohen nga buxheti komunal. Në bazë të analizës financiare të hulumtuar nga të dhënat të cilat janë marrë në AKK, ZKK, dhe burime të tjera financiare, konfirmohet se të hyrat nga shërbimet e administrimit të tokës tejkalojnë shpenzimet e realizuara në AKK dhe ZKK. Këtë e konfirmon edhe analiza e vitit 2010 e kryer nga Banka Botërore. Mirëpo, analiza në shtojcën 2 në figurën 7 tregon që ky tejkalim i të hyrave me shpenzimet dhe investimet kapitale nuk është i lartë.

Përveç buxhetit shtetëror , projektet specifike financohen nga donatorët e jashtëm.

Për financimin e AKK-së në të ardhmen, propozohen tri opsione:

- a. Financimi nga buxheti qeveritar. Në këtë opsion të gjitha kostot janë të mbuluara nga buxheti qeveritar për Agjencinë Kadastrale të Kosovës;
- b. Financimi përmes mbulimit të kostove. Në këtë opsion konsumatori dhe shfrytëzuesit paguajnë për produktet dhe shërbimet e ndërlidhura me shpenzimet e realizuara;
- c. Kombinim i financimit qeveritar me atë të financimit përmes mbulimit të kostove.

Sa u përket shërbimeve të regjistrimit të pronës së paluajtshme do të tentohet që të bëhen përmes mbulimit të kostove. Ndërsa për detyrat dhe përgjegjësitë siq është IKIH, financimi qeveritar shihet si më i përshtatshëm. Projektet specifike mundën ende të financohen nga donatorë të jashtëm.

Çështje kyçe të cilat duhet të avancohen konsiderohen të jenë:

- Zhvillimi i mëtutjeshëm i Sistemit të Informacionit Kadastral për Tokën në Kosovë;
- Rritja e mëtutjeshme e kualitetit të të dhënave kadastrale;
- Reforma institucionale në administrimin e tokës;
- Infrastruktura për informacione hapësinore dhe sistemet për mbledhjen e të dhënave që të mundësohet monitorimi i përdorimit të tokës dhe përmirësimi i menaxhimit të tokës dhe
- Institucionalizimi i praktikave dhe principeve të qeverisjes së mirë.

Sfidat kryesore të AKK-së për implementimin e Planit të Biznesit 2021-2025 konsiderohet të jenë:

- ***Organizimi i AKK-së.*** Momentalisht AKK është nën ombrellën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit. Gjatë hartimit të kësaj Strategjie dhe Planit të Biznesit kemi pasur tri ndryshime për një kohë të shkurtër. Nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, është kaluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit e pastaj në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit. Këto ndryshime të shpeshta të strukturës së Qeverisë dhe kompetencat ndaj AKK-së, humbin rolin dhe fuqinë e funksionimit të AKK-së. Prandaj, në kuadër të këtij dokumenti, propozojmë që AKK të jetë nën ombrellën e Zyres së Kryeministrit;
- ***Hartimi dhe miratimi i ligjeve,*** siq janë Ligji për kadastrë të pronës së paluajtshme dhe Ligji për IKIH. Plotësimi i Ligjit për odat e arkitektëve dhe inxhinierëve në fushën e ndërtimit, ku do të rregullohet themelimi i odës së Gjeodetëve;

- **Harmonizimi i kompetencave institucionale për të drejtat pronësore**, që do të rritë edhe më tej sigurinë juridike për investitorët dhe qytetarët;
- **Rritja e efikasitetit të institucioneve tjera (gjykatat, noterët, përmbaruesit, ndërmjetësuesit etj.)** për zgjidhjen e rasteve, do ta përshpejtojë dukshëm kohën e nevojshme për zgjidhjen e rasteve e për rrjedhojë do ta ulë edhe koston e proceseve për qytetarët dhe bizneset, si dhe do të ndihmojë në krijimin e një klime të favorshme për tërheqje të investimeve; dhe
- **Koordinimi i më tutjeshëm i ofrimit të shërbimeve** për bizneset dhe qytetarët, që konsiston me krijimin e një sistemi të integruar informativ për shërbimet e administratës publike, duke bërë punën e administratës më efektive, zvogëlimin e shpenzimeve të fondeve publike si dhe ato të bizneseve dhe qytetarëve. Do të thotë se qytetarët dhe bizneset do të kenë procedura të thjeshtësuara përmes kryerjes së shërbimeve në një vend.

4. NDIKIMET E PRIORITETEVE DHE STRATEGJIVE TË QEVERISË

Strategjia kombëtare për zhvillim 2016-2021 (SKZH), e hartuar nga Qeveria e Kosovës është një dokument gjithëpërfshirës në kuptimin e krijimit të parakushteve për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit është një ndër prioritetet kryesore të këtij dokumenti, i cili në përmbajtjen e vetë ndërlihet me Planin Strategjik 2021-2025 të AKK-së

Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore në Kosovë, e hartuar nga Qeveria e Kosovës përkatësisht Ministria e Drejtësisë në dhjetor 2016, adreson shumë çështje lidhur me të drejtat dhe regjistrimin e pronave në Regjistrin për të Drejtat në Pronën e Paluajtshme (RDPP). Është një strategji e cila edhe aktualisht identifikon problemet e pronave duke parashikuar edhe zgjidhje të mundshme. Përmbajtja e kësaj strategjie është gjithashtu e ndërlihet me këtë dokument.

Strategjia e qeverisjes elektronike 2009-2015, është një dokument i Departamentit të Teknologjisë Informative, përkatësisht i Qeverisë së Kosovës. Në këtë dokument ndërlihen fushat siq është Legjislacioni si mbështetje e TIK-ut, Interoperabiliteti si aftësi e sistemeve të TIK-ut dhe proceseve logjike që mbështesin shkëmbimin e të dhënave dhe i bëjnë ato të përdorshme për qëllime të ndryshme. Gjithashtu paraqiten sfidat e së ardhmes të cilat kanë të bëjnë me sensibilizimin e autoriteteve vendim marrëse, konkurrenca e lirë, reflektimi ndaj burimeve njerëzore, planifikimi i qëndrueshëm në funksion të parandalimit të rreziqeve dhe së fundmi sfida është edhe ndryshimet politike.

IT Strategjia dhe Plani i Implementimit të AKK-së, e hartuar më 2017, në disa pika të saj konfirmon ndërlihdje të synimeve të këtij dokumenti në kontekstin e çështjeve të diskutuara edhe me zyrtarë dhe grupe të interesit nga hartuesi i kësaj strategjie dhe plani të biznesit.

Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim, në kuadër të Bankës Botërore do të financojë: Projektin për regjistrimin e pronës së paluajtshme dhe infrastrukturës gjeohapësore (REGIP). Ky projekt konsiderohet si ndërlidhje me të gjitha komponentet e tij të cilat pasqyrojnë një pjesë të përmbajtjes së Strategjisë dhe Planit të Biznesit 2021-2025.

Projektligji për kadastrën dhe projektligji për Infrastrukturën kombëtare të informacioneve hapësore janë pjesë kryesore të konsideruar në këtë dokument. Projektionet e këtyre projektligjeve paraqesin pjesën esenciale të reformës kadastrale në Kosovë. Të dy këto projektligje pas miratimit në Kuvendin e Republikës së Kosovës do jenë edhe themel i zhvillimeve të parapara në këtë strategji dhe plan të biznesit. Pjesa më e madhe e këtij dokumenti, përkatësisht zbatimi i suksesshëm i tij, është e ndërlidhur me reformën ligjore, edhe pse shumica e planit dhe zbatueshmëria është e mundshme edhe para miratimit të legjislacionit të ri.

Strategjia zhvillimore afatshkurtër 2009-2011 dhe Plani 5 vjeçar i biznesit për qëndrueshmërinë e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, janë marrë si referenca për hartimin e këtij plani biznesi.

Raporti vjetor i Agjencisë Kadastrale të Kosovës 2019 dhe Plani i Punës 2020 gjithashtu ka disa adresime që ndërlidhen me Strategjinë dhe Planin e Biznesit. Në veçanti pjesa e planit të punës, përmban projekte me afat të zhvillimit më të gjatë në periudha të planifikimit.

5. KORNIZA LIGJORE DHE ORGANIZIMI I KADASTRIT

AKK-ja është themeluar me qëllimin e veçantë të menaxhimit të kadastrit dhe të drejtave të regjistrimit të pasurisë të paluajtshme në Kosovë, në këtë proces AKK-ja është rregullatorë e njëkohësisht edhe organ koordinues, por jo menaxhues i drejtpërdrejt i ZKK-ve

Agjencia Kadastrale e Kosovës është shkallë e dytë e vendosjes në procedurë ankimore administrative, ndërsa ka një sistem të integruar në kontekst të teknologjisë dhe kërkesave për personel. Kompetencat për strukturën e përgjithshme organizative dhe menaxheriale i ka komuna respektivisht Kryetari i Komunës, i cili i realizon ato përmes Drejtorëve të Drejtorive, e të cilët në bazë të ligjit për pushtetin lokal dhe Statutet Komunale, kanë cilësinë e këshilltarit të Kryetarit të Komunës.

5.1. KORNIZA LIGJORE

Agjencioni Kadastral i Kosovës funksionon dhe është i ndërlidhur me disa ligje të cilat janë të domosdoshme për funksionim:

- Ligji mbi Themelimin e Regjistrimit të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme Nr.2002-5;
- Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për kadastrin Nr. 02 L-96;
- Ligji Nr 04_L-009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2002-5 për themelimin e regjistrimit të drejtave të pronës së paluajtshme;
- Ligji për Kadastër Nr. 04-L/013;

- Ligji Nr. 04/L-071 për sistemin e adresave;
- Ligji mbi Plotësimet dhe ndryshimet e Ligjit të RDPP 2003-13;
- Si dhe aktet tjera nënligjore.

Ligjet aktuale ishin pjesë e zhvillimeve pozitive nga fusha e kadastrit dhe regjistrimit të të drejtave të pronës së paluajtshme. Këto ligje deri më tani kanë dhënë një impakt pozitiv në zhvillimin edhe avancimin organizativ, krijimin dhe dhënien e shërbimeve dhe produkteve të rëndësishme për qytetarët dhe institucionet e Kosovës, avancimet në nivel Evropian dhe Rajonal, kërkesat e mëdha lidhur me sasinë dhe cilësinë e informacioneve, kërkesa për shërbime më efikase, e më cilësore dhe më të lira, krijojnë nevojën, madje domosdoshmërinë e qasjes së një reforme legjislative nga fusha e kadastrit dhe krijimit të gjeoinformacioneve.

Ligji i ri për kadastrin është i draftuar gjatë viteve të mëhershme, mirëpo pas ndryshimeve Qeveritare është kthyer në pikën zero. I njëjti është avancuar konform zhvillimeve aktuale, dhe është në planin e Strategjisë Legjislative për vitin 2021.

Ligji për Infrastrukturën Kombëtare të Informacioneve Hapësinore ka kaluar në lexim të parë nga legjislatura e gjashtë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, megjithatë pas ndryshimeve Qeveritare është kthyer në pikën zero. I njëjti është avancuar konform zhvillimeve aktuale dhe është në planin e Strategjisë Legjislative për vitin 2021.

Përvojat ndërkombëtare tregojnë se është i nevojshëm një adresim i mirëfilltë i detyrave dhe përgjegjësive qeveritare në fushën e administrimit të tokës drejt një institucioni kombëtar funksional. Sipas kësaj perspektive është e domosdoshme të ketë një organizim për administrim të tokës me ZKK-të si pjesë e integruar

e AKK-së. Rezultati i kësaj do të ishte, një implementim më i qëndrueshëm i politikave të administrimit të tokës.

Përmirësimi i kriterëve por edhe ri-rregullimi i procedurave teknike, administrative dhe ligjore në rindërtimin e informacioneve kadastrale, do të jetë njëra ndër pikat kyçe në ligjin e ri për kadastër të cilin ky dokument e koncepton si një hallkë ndërlidhëse dhe e domosdoshme legjislative. Regjistrimi i të drejtave reale të pronës, bazuar në gjendjen në terren, është një prej objektivave të reformës ligjore që duhet plotësuar përmes regjistrimit sistematik të drejtave të pronës së paluajtshme.

Propozohet gjithashtu edhe ndryshimi i emërimit të tanishëm të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, duke marrë parasysh edhe kompetencat shtesë për sistemin e adresave, si dhe menaxhimin dhe mirëmbajtjen e informacioneve hapësinore sipas draft Ligjit për Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH).

Udhëzimet Administrative nga fusha e kadastrës dhe regjistrimit të pronës dhe Udhëzimet Administrative nga fusha e sistemit të unifikuar të adresave janë një hap i mirë i implementimit të reformës kadastrale. Agjencia Kadastrale e Kosovës respektivisht Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (e integruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit dhe së fundi në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit), ka nxjerrë disa Udhëzime Administrative të avancuara, gjithnjë duke mbetë në kuadër të ligjit aktual për Kadastër, dhe ligjeve të tjera relevante.

Pasi rregullimi i procedurave teknike-normative të aktiviteteve kadastrale për azhurnimin sporadik dhe sistematik të të dhënave kadastrale ka qenë shumë e nevojshme, AKK gjatë vitit 2020 ka kompletuar edhe Kornizën për punë kadastrale, si dhe doracakë pune për RIK, KN, Sistemin e Adresave dhe Udhëzuesin për procedurat e regjistrimit të pronave të paluajtshme.

Gjatë hartimit të kësaj strategjie dhe plani të biznesit janë marrë parasysh kërkesat për ndryshime të koncepteve teknike në avancimin e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve, sigurisë së tyre por edhe përshtatjes së mundësive që ato të dhëna të përdoren edhe në sistemet e mëdha të avancuara të krijimit, menaxhimit dhe distribuimit të produkteve dhe shërbimeve për nevojat e shfrytëzuesve të ndryshëm.

5.2 ORGANIZIMI AKTUAL I AKK-së

Për të përmbushur detyrimet e veta në përputhje me legjislacionin aktual, AKK-ja ka strukturën e saj organizative të rregulluar në bazë të Rregullores Nr.20/2014 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kadastrale të Kosovës (në tekstin e mëtejme AKK)¹. AKK aktualisht ka gjithsej një staf prej 56 punëtorësh.

Në krye të hierarkisë së AKK-së është Drejtori Ekzekutiv, 5 drejtorate dhe e organizuar në sektorë.

Drejtorati i regjistrimit mbi pronat e paluajtshme, është i organizuar në 3 sektorë:

1) Sektori për Kadastër GIS dhe Matje; 2) Sektori për RDPP dhe SIKTK; 3) Sektori për kontroll të kualitetit.

Drejtorati për Gjeoinformacion është e organizuar në 4 sektorë. 1) Sektori për IKIH; 2) Sektori i regjistrimit të adresave; 3) Sektori për KOPOS; 4) Sektori për Hartografi.

¹ Rregullore e brendshme e AKK-së nr.20/2014 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

Drejtorati për menaxhimin e sistemit të teknologjisë së informacionit kadastral, e cila është e organizuar në 2 sektorë. 1) Sektori i Administrimit të infrastrukturës së TI-së kadastrale dhe 2) Sektori për administrim të të dhënave për kadastrë.

Drejtorati Ligjor, është i organizuar në 2 sektorë. 1) Sektori për hartimin dhe harmonizimin e legjislacionit dhe 2) Sektori për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit, mbështetjen dhe bashkëpunimin institucional në fushën e legjislacionit.

Drejtorati për financa dhe shërbime të përgjithshme, është i organizuar në tri sektore. 1) Sektori për burime njerëzore; 2) Sektori për buxhet dhe financa dhe 3) Sektori i TI-së dhe shërbime logjistike.

Organogrami aktual i AKK-së




Figura 1. Organogrami i AKK-së
(Burimi: Rregullore e brendshme e AKK-së nr.20/2014)

5.3 ZYRAT KADASTRALE Komunale

ZKK-ja është organ komunal dhe është përgjegjëse për funksionimin e kadastrit. ZKK-ja kryen të gjitha aktivitetet kadastrale në përputhje me kompetencat e deleguara nga niveli qendror, dispozitat ligjore dhe udhëzimet administrative të nxjerra nga AKK-ja dhe Ministria. Nëpunësit e ZKK-së duhet të jenë të certifikuar nga AKK-ja. Të gjitha aktivitetet e ZKK-së realizohen dhe pasqyrohen në bazën qendrore të të dhënave të AKK-së.

Në përgjithësi organizimi në dy nivele i aktiviteteve kadastrale konsiderohet si element sfidues i suksesit ngase drejtorët në komuna në të shumtën e rasteve zgjedhën nga politika, pasi ka edhe mungesë të ekspertëve të profileve të ndryshme, për shkak se personeli kryesisht zgjidhet nga potenciali në nivel komune. Për shkak të përgjegjësiave menaxheriale në kuadër të komunës, ZKK-të, ngarkohen edhe me punët të tjera të komunës, në vend se ato të koncentrohen në aktivitetet kryesore për kadastër dhe regjistrim të të drejtave të pronës së paluajtshme.

6. KORNIZA INSTITUCIONALE

Efikasiteti i institucioneve të cilat merren me administrim të tokës ka ndikim të konsiderueshëm mbi standardet e zhvillimit social dhe ekonomik të vendit. Efikasiteti i tyre varet nga korniza ligjore, organizimi dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të ndara si dhe me përgjegjësi e kompetenca të qarta për secilin institucion.

Konceptet funksionale të administrimit të tokës në ekonomitë e udhëhequra nga tregu kryesisht kanë një sektor të zhvilluar privat, i cili operon brenda një kornize të definuar dhe të rregulluar.

Siguria e së drejtës në pronë dhe e administrimit të tokës është përgjegjësi e shtetit, prandaj duhet të krijohen mekanizma kontrolli efektiv në krijimin dhe zbatimin e politikave për arritjen e cilësisë për të siguruar përgjegjësi të nevojshme.

6.1. KOMITETI NDËRMINISTOR PËR ADMINISTRIM TË TOKËS DHE INFRASKTUKURË KOMBËTARE TË INFORMACIONIT HAPËSINOR

Komiteti ka rol këshillues ndaj Qeverisë dhe AKK-së, rol të monitorojë dhe bashkërendojë iniciativat në fushën e administrimit të tokës dhe të IKIH-së për të siguruar qëndrueshmëri dhe mbështetje të interesave shtetërore, komunale dhe interesave të sektorit privat dhe përpjekjeve të organizatave të përfaqësimit shtetëror ndërkombëtarë në cilësinë e donatorëve, si dhe shoqata e organizata joqeveritare.

Fushat e tilla janë kadastri, tatimi në pronën e paluajtshme, funksionimi i sistemeve të hipotekimit, përmirësimi i planifikimit urban edhe zhvillimi i infrastrukturës, përkrahja e menaxhimit dhe mbrojtjes së mjedisit, si dhe përpilimi i të dhënave

statistikore për të ndihmuar planifikimin ekonomik dhe zhvillimor. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi është një strategji e qartë dhe e nevojshme për administrimin efikas të tokës.

Në dispozicion të komitetit duhet të jenë grupet e themeluara punuese për çështje specifike me anëtarë nga sektori qeveritar, komunal dhe privat.

Duhet të merret parasysh fuqizimi i komitetit të administrimit të tokës dhe IKIH me fuqi vendim-marrëse në fusha të caktuara në emër të Qeverisë.

6.2. KOMITETI KOORDINUES ME DONATORËT

Ky Komitet ka për qëllim koordinimin e aktiviteteve me donatorë, dhe përdorimin e fondeve për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Biznesit të AKK-së, dhe informimin për aktivitetet e sektorit kadastral në Kosovë. Ky Komitet gjithashtu ofron këshilla dhe mbështetje për Komitetin Ndërmnistror të Administrimit të Tokës nëngritjen e shkallës së transparencës, shmangien e mundësive për duplikimin e projekteve, diskutimi i rezultateve dhe sfidat me të cilat ballafaqohet administrimi i tokës. Ky komitet do të ketë rol së paku për periudhën e zbatimit të këtij dokumenti, duke pas parasysh projektin e Bankës Botërore për Drejtat e Pronës Kadastrale dhe Infrastrukturën Gjeohapësinore (REGIP), si dhe projekte të tjera. Njësia për implementimin e projekteve (pasuese e Zyrës për koordinimin e Projekteve) siguron që të gjitha aktivitetet e projekteve të jenë në përputhje me ligjet vendore dhe kërkesat, procedurat dhe rregullat e vetë donatorëve apo përkrahësve si Banka Botërore, SIDA, USAID, GIZ, JICA, Autoriteti Norvegjez për Kadastër dhe Hartografi Kartevket, Qeveria Holandeze etj.

6.3. ORGANIZIMI VERTIKAL I KADASTRIT

Çështja e organizimit vertikal të kadastrës së Kosovës, është theksuar edhe në kapituj të tjerë të këtij dokumenti. Duke qenë se në masë të madhe reforma e kadastrit në Kosovë është në lidhshmëri esenciale me çështjen e vertikalizimit, ky plan biznesi në mënyrë të veçantë merr në konsideratë përcaktimin e strategjisë dhe proceseve të organizimit kadastral apo reformën kadastrale e cila garanton një qëndrueshmëri të zhvillimit të kadastrit në Kosovë.

Në dekadën e ardhshme në Evropë do të shihet zhvillim i fuqishëm i legjislacionit të përbashkët, përdorim i përbashkët i teknologjisë dhe infrastrukturës, dhe këmbim i shpeshtë i praktikave më të mira në mes të institucioneve kombëtare për administrimin e tokës.

Që të përshpejtohen këto zhvillime shihet dhe pritet që integrimi i proceseve të administrimit të tokës në një institucion kombëtar është i rëndësishë së veçantë, për arsye të efikasitetit, kostove, punëve publike dhe arsye tjera.

Është shumë e rëndësishme të kuptohet se themelimi i një institucioni kombëtar për administrimin e tokës nuk ka ndikuar në politikat decentralizuese të shteteve të përfshira. Për më tepër, kontributi i komunave drejt shërbimit në nivelin kombëtar mundet të organizohet vetëm nëse ekziston një agjenci kombëtare e organizuar vertikalisht.

6.3.1. Autonomia udhëheqëse e Agjencisë Kadastrale të Kosovës

Përforcimi i udhëheqjes së AKK-së nga ana e Qeverisë është diçka që sugjerohet, por gjithashtu sugjerohet edhe zhvillimi i autonomisë së AKK-së.

Për të përmirësuar efikasitetin e afarizmit të AKK-së dhe në të njëjtën kohë për të përforcuar mundësinë e Qeverisë për ta monitoruar atë, Qeveria duhet të fus në veprim një sistem të menaxhimit sipas objektivave dhe rezultateve. Objektivat duhet të jenë të sakta, konkrete dhe operative në mënyrë që të funksionojnë si kritere për vlerësim. Objektivat jepen dhe rezultati pritet. AKK-ja do të gëzojë më tepër liri veprimi dhe diskrecion në punën e vet të përditshme dhe do të gëzojë liri për të organizuar dhe kryer punët e përditshme.

AKK-ja duhet të marrë mandatin e vet nga Qeveria e Kosovës përmes njëres nga ministritë apo të propozohet në ligjin e ri nën ombrellën e Zyres së Kryeministrit (modeli i Maqedonisë Veriore). Mandati duhet të definohet qartë në ligje dhe udhëzime administrative përmes së cilave paraqitet misioni i gjithmbarshëm i AKK-së dhe fushat e kompetencës.

Objektivat e nivelit të lartë paraqesin bazën për objektiva konkrete të cilat duhet të zhvillohen nga AKK-ja për të udhëzuar zbatimin e mandatit, masat e mbikëqyrjes dhe kontrollit të kadastrit dhe aktivitetet mbi të drejtat ndaj pronës së paluajtshme të kryera nga zyrat komunale të kadastrit (ZKK) dhe gjeodetët privat të licencuar, si dhe aktivitetet dhe operimet zhvillimore të AKK-së.

Fuqizimi i AKK-së me legjislacion të modernizuar do të nënkuptojë përcaktimin e qëllimeve afatgjata për të gjitha punët dhe shërbimet e kryera nga AKK-ja. Kjo gjithashtu AKK-së do t'i jap përgjegjësi dhe autoritet më të madh.


Aftësitë dhe njohuritë e duhura menaxheriale mbi administrimin e tokës duhet të bartin peshë më të madhe se sa këndvështrimet politike. Një kontratë pune prej 4 – 6 vite për Drejtorin Ekzekutiv do të ishte më e preferuar.

Bazuar në synimin e organizimit vertikal të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, kjo Strategji dhe Plan i Biznesit në përmbajtjen e vet konfirmon nevojën e ndryshimit të strukturës organizative. Në këtë përmbajtje vlerësohet që emërtimi i udhëheqësit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës duhet të jetë Kryeshefi Ekzekutiv i AKK-së. Për shkak të volumit të punëve dhe përgjegjësi të kësaj Agjencie rekomandohet që të themelohet edhe pozita e zv. Kryeshefit Ekzekutiv, ndërsa së paku në periudhën e vlefshmërisë së këtij plani biznesi, institucionet lokale të mbasin Zyrat Komunale Kadastrale (ZKK) duke vendosë një strukturë funksionale të specifikuar për të gjitha komunat apo ZKK-të, përkatësisht përcaktimin e sektorëve të veçanta varësisht prej komunës dhe kapacitetit të tyre financiar, njerëzor dhe menaxherial. Rrjeti i ZKK-ve imponon edhe themelimin e pozicionit të auditorit të brendshëm si dhe zgjerimi i zyrës së prokurimit.

Duhet të ketë njësinë e trajnimit nga se ngritja e kapaciteteve të rëndomta duhet të jetë e vazhdueshme. Kjo do të thotë që njësitë organizative - departamentet aktuale do të mbasin në funksionalitetin e tyre por do të riorganizohen, në kontekstin e kërkesave nga riorganizimi i ri.

Agjencia Kadastrale e Kosovës në kompetencën e vet parashihet të menaxhojë edhe Infrastrukturën Kombëtare të Informacioneve Hapësinore dhe përgjegjësi të tjera të cilat do të mbulohen në strukturën e re organizative, e cila me të gjitha specifikat e veta do të trajtohet me institucionin mbikëqyrës dhe grupe të interesit përfshirë edhe menaxhmentin e AKK-së.

Organogrami sipas organizimit vertikal



6.3.2. Roli i ZKK-ve në reformën kadastrale

Si rrjedhojë e reformës kadastrale, përkatësisht ndryshimit të konceptit strukturor organizativ të AKK-së, duke qenë se Zyrat Komunale Kadastrale, parashihet të jenë pjesë e një organizimi vertikal të kadastrës së Kosovës, do të reflektojnë ndryshime edhe të strukturës dhe funksionimit të ZKK-ve të cilat duhet ta ruajnë misionin e deritanishëm duke e avancuar atë edhe me elemente të tjera të cilat do të përcaktohen nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, si autoritet qendror për realizimin e misionit të saj.

Organizimi i tanishëm i ZKK-ve është shumë heterogjen për kah struktura organizative, emërtimi sipas statuteve komunale por edhe për nga kompetencat profesionale dhe menaxheriale, që është konsideruar si njëra prej dobësive edhe në SWOT analizë, dhe e cila është pjesë përmbajtëse e këtij dokumenti. Në shumicën e ZKK-ve aplikohet një menaxhment tradicional, i emëruar kryesisht në baza politike, i cili nuk i plotëson kërkesat profesionale dhe menaxheriale në përputhje me misionin dhe vizionin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Komunat nuk kanë strategji të hartuara për një ngritje të kompetencave të cilat do të mund të ballafaqohen me synimet reformuese të parapara në këtë dokument.

Agjencia Kadastrale e Kosovës përmes burimeve të ndryshme financiare ka bërë investime në infrastrukturën e ZKK-ve si në rregullimin e hapësirave e vetëvetiut edhe në skemën e funksionimit të zyrave, trajnimin dhe përdorimin e sistemit për menaxhimin e të dhënave në SIKTK. Gjithsesi këto mund të konsiderohen si përpjekje për të krijuar një bazë strukturore për tu përshtatur konceptit të ri organizativ të projektuar edhe në draft ligjin për kadastrë.

Reforma e re kadastrale parashikon procedura më efikase dhe shërbime cilësore, duke e përcaktuar një strukturë organizative të kompetencave dhe përgjegjësiive profesionale.

Kjo strategji dhe plan biznesi ka të projektuar mundësinë që ZKK-ja të jetë një organizim në kuadër të Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Kjo zyrë propozohet të quhet Zyra Kadastrale Lokale (ZKL), përkatësisht stafi dhe të gjitha aktivitetet e zyrës do të menaxhohet nga AKK-ja, respektivisht nga departamenti përkatës i AKK-së. Zyra parashihet të udhëhiqet nga shefi zyrës, ndërsa zyra parashihet të organizohet në tre sektorë: Sektori i administratës, Sektori i azhurnimit dhe Sektori i kontrollit të kualitetit.

Skema e propozuar organizative e njëjës prej gjashtë qendrave kryesore në Kosovë

Nr. Rend.	Sektori	Emërtimi
1	Zyra Kadastrale Lokale	Shefi i Zyrës Kadastrale Lokale
2	Sektori i Administratës	1. Udhëheqës sektori 2. Jurist 3. Pranimi, distribuimit dhe arkivimi lëndëve 4. Shërbimi i produkteve kadastrale 5. Vozitës, figurant, mirëmbajtës i pajisjeve 6. Mirëmbajtja e hapësirave 7. Zyrtar Financiar 8. Zyrtar i IT-së
3	Sektori i Regjistrimit të Pronës së Paluajtshme	1. Udhëheqës sektori 2. Azhurnimi grafik 3. Azhurnimi tekstual
4	Sektori i kontrollit të kualitetit	1. Udhëheqës sektori 2. Kontrolli i kualitetit

Koordinimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin do ta bën shefi i zyrës. Sektori i administratës të procesoj aspektin administrativ dhe ligjor të lëndëve, kjo garanton një shqyrtim ligjor të bazuar në ligj, por garanton edhe efikasitet në ecurinë dhe përgjegjshmërinë e shqyrtimit të lëndës. Azhurnimi i bazës grafike dhe tekstuale në bazë të një aktvendimi nga sektori i administratës dhe i nënshkruar nga shefi apo regjistruesi, do të konsiderohet aktivitet teknik-juridik i bazuar në normat teknike të sanksionuara me Udhëzimet Administrative dhe Kornizat për punë kadastrale.

Sektori i Regjistrimit të Pronës së Paluajtshme, do të merret me analizën dhe regjistrimin e të dhënave grafike dhe tekstuale në bazë të kërkesave të palëve, do të vlerësojë cilësinë e shërbimit dhe produkteve, do të japë edhe konsulenca profe-

sionale lidhur me shqyrtimin e lëndëve. Të gjithë punonjësit do të nënshtrohen trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme, duke i ngrit kapacitetet e secilit zyrtar, i cili do të kryhet nga departamenti i trajnimeve në kuadër të AKK-së. Mitrovica, Peja, Prizreni, Gjakova, Ferizaji dhe Gjilani do të kenë model të njëjtë organizativ. Në bazë të analizës së gjendjes funksionale të tanishme, komunat të tjera mesatarisht do të mund ti kryenin funksionet e veta me një staf prej 15 veta, ndërsa ZKK-ja e Prishtinës sipas vlerësimit dhe analizës duhet të ketë jo më pak se 35 vetë. Sipas këtij vlerësimi dhe analizave të përbashkëta edhe më përfaqësuesit e Zyrave Kadastrale dhe AKK-së, vlerësohet që numri i përgjithshëm në nivel vendi do të jetë 650 zyrtarë – punëtorë.

6.3.3. Gjeodetët dhe kompanitë e licencuara gjeodete

Përfshirja e gjeodetëve dhe kompanive gjeodete të licencuara, konsiderohet një ndërlidhje e rëndësishme me AKK-në si autoritet i vetëm për administrimin, menaxhimin dhe shpërndarjen e informacioneve kadastrale dhe gjeohapësinore. Synim i gjeodetëve dhe kompanive gjeodete të licencuara është mundësia e vetërregullimit dhe zhvillimit duke themeluar Odën e Gjeodetëve. Themelimi i Odës, do të kornizojë avansimin profesional të gjeodetëve, monitorimin e zbatimit të rregullave themelore të funksionimit të kompanive. Kjo formë e vetë-rregullimit do të zhvillojë komunikimin dhe bashkëpunimin me AKK-në, e cila si institucion i vetëm do të vendosë rregullat e licencimit, zbatimit të Ligjit përmes Udhëzimeve Administrative përkatëse si dhe do të monitorojë dhe vlerësojë zbatimin e kornizave për matjet kadastrale, zhvillimi i të cilave do të jenë në koherencë me ndryshimet legislative. Gjeodetëve dhe kompanive gjeodete të licencuara duhet t’iu ofrohen

trajnime për menaxhment, afarist/financa, etikë, ligje afariste/kontraktuese, kornizë ligjore dhe principe të ndërlidhura me afarizmin e tyre.

Kompetenca e gjeodetëve dhe kompanive gjeodete të licencuara është e rregulluar me ligje dhe akte nënligjore. Në vitin 2019, ka pasur ndryshime të rëndësishme në qartësimin e rolit të gjeodetëve dhe kompanive gjeodete të licencuara me atë publik apo ZKK-ve. Tani përqëndrimi i ZKK-ve është kontrolli i kualitetit dhe mirëmbajtja e regjistrit të pronave të paluajtëshme .

Deri më tani 131 gjeodet, 25 teknik të gjeodezisë dhe 25 kompani gjeodete janë licencuar për matje kadastrale me lokacione në pjesë të ndryshme të Kosovës, dhe ky sektor është pjesë aktive e hartimit të legjislacionit lidhur me funksionimin e sektorit të kadastrës.

6.3.4. Bashkëpunimi me Shoqatën – Odën e Gjeodetëve

Shoqata e Gjeodetëve është shoqatë profesionale, e cila bashkon të gjithë gjeodetët në nivel të Republikës së Kosovës, e të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret të parapara me statutin dhe rregulloret e Shoqatës. Përmes aktiviteteve të veta influencon që cilësia e shërbimeve kadastrale dhe gjeodezike, organizimi, legjislacioni (përfshi Ligjet dhe Udhëzimet Administrative, rregulloret dhe instrukcionet) ti plotësojnë standardet e parapara.

Është një mundësi e mirë që përmes seminareve, punëtorive, trajnimeve të ndryshme dhe konferencave, të ngriten kapacitetet e gjeodetëve (përfshirë edhe ata që janë pjesë e shërbimit civil në administratën shtetërore), në fusha të ndryshme të gjeodezisë dhe gjeoinformacioneve, e që reflektojnë edhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve kadastrale.

6.4. COVID 19

Me situatën e krijuar nga pandemia COVID-19 Agjencia Kadastrale e Kosovës duhet planifikojë edhe masa shtesë në realizimin me sukses të Planit Zhvillimor të saj i paraqitur në këtë Plan Strategjik dhe Plan Biznesi dhe Veprimi, por edhe aktivitetet e parapara mund të ndihmojnë në rimëkëmbjen ekonomike të vendit në fazat e ardhshme nga pasojat e COVID-19.

7. ZHVILLIMET E ADMINISTRIMIT TË TOKËS

7.1. ZHVILLIMET EVROPIANE

Komisioni Ekonomik për Evropën e Kombeve të Bashkuara (KEE-KB) ka të publikuar dokumentin “Administrimi i tokës në Regjionin e KEE-KB, trendet zhvillimore dhe principet kryesore”. Ky dokument bazohet në premisën se çdo shtet duhet të ketë një sistem formal të regjistrimit të tokës dhe të drejtave pronësore në mënyrë që të ndihmojë qeverisjen e mirë dhe siguroj pronësi të sigurt mbi tokën, mbi investimet dhe mbi interesat tjera publike dhe private në pasurinë e paluajtshme. Sistemet efektive për regjistrimin e pronësisë mbi tokën, vlerën e tokës dhe përdorimin e tokës janë themeli mbi të cilin varet operimi efikas i ekonomisë së tregut dhe ato përforcojnë menaxhimin e qëndrueshëm dhe produktiv të burimeve tokësore. Sistemet e tilla zvogëlojnë rrezikun ndaj dhënësve të huave hipotekare (pengut) dhe si rezultat edhe normat e kamatave që ngarkohen, duke ndihmuar efikasitetin më të lartë dhe rritjen ekonomike.

Nga hulumtimet dhe analizat e zhvillimeve në shtetet e Evropës qendrore dhe lindore, janë nxjerrë disa rekomandime të cilat do të konsiderohen si mësim apo përvoja, duke i adresuar edhe në këtë Strategji dhe Plan Biznesi.

Duhet ndërtuar një qëndrueshmëri sipas cilitdo koncept apo sistem për administrimin e tokës. Teknologjia, sidomos pajisjet elektronike duhet përmirësuar në intervale të rregullta kohore, dhe të azhurnohen vazhdimisht të dhënat digjitale. Baza e të dhënave digjitale do të duhej të rindërtohet, konform teknologjisë e cila po ndryshon jashtëzakonisht me një dinamikë të lartë, duke siguruar qasje të vazhdueshme dhe mundësi të përdorimit të vazhdueshëm të dokumenteve digjitale

që mbahen në arkiva. Strategjitë për mbulimin e kostove janë thelbësore në mënyrë që të financohen këto përmirësime. Kërkesat nga përdoruesit dhe mundësitë e krijuara nga teknologjia dhe vëllimi në rritje i të dhënave, të gjitha këto tregojnë se sistemet e administrimit të tokës duhen të jenë dinamike dhe vazhdimisht të rishikohen që të sigurohet se ende janë të përshtatshme për përdorim modern.

Transaksionet e ndërlidhura me tokën dhe mirëmbajtja e informacioneve do të kryhen në mënyrë elektronike. Autenciteti i atyre që përdorin sistemin duhet të kontrollohet në mënyrë sistematike. Integriteti i transaksioneve të jetë i garantuar dhe të mos ketë mundësi për palët që të mohojnë se janë të përfshirë. Siguria dhe privatësia e të dhënave personale duhet të ruhet dhe kjo duhet balancuar me nevojën për të qenë të hapur (transparent). Prandaj, duhet të ketë udhëzime të qarta në lidhje me atë se kush mund të përdor informata nën çfarë rrethanash dhe në çfarë mënyra.

Edhe në epokën elektronike, është faktori njerëzor ai i cili përcakton se a janë të suksesshme reformat. Sukseset dhe dështimet e reformave të administrimit të tokës mundën gati se tërësisht t'i ngarkohen cilësisë së menaxhimit dhe njerëzve të cilët janë përgjegjës për sistemet. Duhet investuar në ngritjen dhe mbajtjen e kapacitetit të njerëzve për t'i menaxhuar sistemet e administrimit të tokës.

Është çështje e gjykimit (mendimit) kombëtar se cili sistem është më i përshtatshëm për cilindo shtet. Hulumtimi i Komisioni Ekonomik për Evropën i Kombeve të Bashkuara (KEE-KB) nuk rekomandon përgjigje unike për problemin e përcaktimit se çfarë është më e mira në cilindo rast individual. Megjithatë, është e rëndësishme të njihen trendet ndërkombëtare dhe të bëhen përgatitjet për bashkëpunim më të gjerë ndërkombëtar në kontekstin global.

Duhet përpjekje që në një të ardhme të afërt të integrohen të dhënat e vlerësimit masiv duke siguruar shfrytëzimin edhe të publikut në të dhënat e Infrastrukturës Kombëtare të Informacioneve Hapësinore (IKIH).

Në këtë dokument janë konsideruar edhe përvojat nga vendet fqinje me të cilat kemi një lidhje dhe një kulturë të përbashkët të menaxhimit të sistemeve gjeoinformative. Lidhur me këtë grupi i ekspertëve të kompanisë me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesve të kompanive private ka realizuar vizitë në Odën e Gjeodetëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me përfaqësim të kompanive private të licencuara të Maqedonisë së Veriut, përfaqësues të Agjencisë për Kadastër dhe paluajtëshmëri dhe përfaqësues të edukimit të lartë nga Republika e Maqedonisë së Veriut, me ç'rast janë marrë informacione të rëndësishme lidhur me organizimin, funksionimin, financimin dhe menaxhimin e Autoritetit Kadastral Shtetëror.

7.1.1. Iniciativa Evropiane – INSPIRE

INSPIRE është një iniciativë e BE-së për të krijuar një infrastrukturë për informacionin hapësinor në Evropë që synon të ndihmojë për ta bërë informacionin hapësinor ose gjeografik më të arritshëm dhe të ndërveprueshëm për një gamë të gjerë qëllimesh që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm.

Direktiva INSPIRE përcakton një kornizë të përgjithshme për një infrastrukturë të të dhënave hapësinore për qëllimet e politikave mjedisore të Komunitetit Evropian dhe politikave ose aktiviteteve që mund të ndikojnë në mjedis. Direktiva INSPIRE hyri në fuqi në 15 maj 2007.

INSPIRE bazohet në infrastrukturën e informacionit hapësinor të krijuar dhe operuar nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Direktiva adreson 34 tema të të dhënave hapësinore të nevojshme për aplikime mjedisore.

Për të siguruar që infrastrukturat e të dhënave hapësinore të shteteve anëtare janë të pajtueshme dhe të përdorshme në një komunitet dhe kontekst ndërkufitar, Direktiva INSPIRE kërkon që legjislacioni shtesë ose Rregullat e Përbashkëta Zbatuese të

miratohen për një numër fushash specifike (metadata, ndërveprueshmëria, grupe dhe shërbime të të dhënave, shërbime të rrjetit, shpërndarje dhe monitorim, si dhe raportim i të dhënave dhe shërbimeve).

Shpërndarja e të dhënave sipas INSPIRE mund të rrisë ekonominë që lidhet me sektorin e IT, rrit cilësinë e jetesës dhe përkrah administratën publike përmes rritjes së transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare.

Për organizimin e zbatimit të Direktivës INSPIRE është përgjegjës i ashtuquajturi “grupi i kuartetit”, i përbërë nga, Drejtoria e Përgjithshme për Mjedisin brenda Komisionit Evropian, Qendra e Përbashkët e Kërkimeve (eng. Joint Research Center), Agjencia Evropiane për Mjedisin dhe Eurostat.

7.1.2. Infrastruktura Kombëtare e Informacioneve Hapësinore në Kosovë (IKIH)

Republika e Kosovës është duke implementuar një infrastrukturë moderne të administrimit të tokës dhe është duke ndjekur praktikën më të mirë të shteteve të tjera anëtare të Bashkimit Evropian. Hyrja në Bashkimin Evropian (BE) nënkupton që Republika e Kosovës do të duhet t’i nënshtrohet direktivave të lëshuara nga Komisioni Evropian (KE). Sa i përket administrimit të tokës dhe të dhënave gjeohapësinore, duhet të merret parasysh Infrastruktura për informata hapësinore e Komisionit Evropian (INSPIRE).

Implementimi i konceptit të Infrastrukturës Kombëtare të Informacioneve Hapësinore (ang. NSDI) gjithashtu është i një rëndësie të veçantë për Republikën e Kosovës, pasi vendi përditë e më shumë po ballafaqohet me rritje të kërkesës për të dhëna gjeohapësinore, të cilat janë të nevojshme për planifikim, vendimmarrje dhe përcjellje të efekteve në zona të ndryshme.

Infrastruktura Kombëtare për Informacione Hapësinore (IKIH) duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të sigurohet se të dhënat hapësinore ruhen, vihen në dispozicion dhe mirëmbahen në nivelin më të përshtatshëm për të qenë e mundur të kombinohen të dhëna hapësinore nga burime të ndryshme nga të gjitha institucionet në mënyrë të qëndrueshme, si dhe për t'i shkëmbyer ato ndërmjet shumë përdoruesve dhe aplikacioneve, për të qenë e mundur që të dhënat hapësinore të mbledhura në një nivel të caktuar të autoritetit publik të shkëmbehen ndërmjet autoriteteve të tjera publike etj.

Shumë institucione në Republikën e Kosovës kanë krijuar informacione gjeo-hapësinore digjitale, ku është më se e domosdoshme që të bëhet standardizimi i tyre dhe me ligj të rregullohen edhe aspektet e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të këtyre të dhënave midis institucioneve përkatëse. Ideja është që të prodhohen dhe të mbledhen të dhënat hapësinore vetëm njëherë me kosto të ulët dhe që ato mund të shkëmbehen dhe të përdoren nga të gjithë.

Deri më tani në Republikën e Kosovës janë bërë disa hapa konkret, ku me ligj është përcaktuar Agjencia Kadastrale e Kosovës si koordinatorë për IKIH. Është krijuar komiteti ndërministror për administrimin e tokës dhe IKIH, si dhe gjithashtu janë realizuar projekte të rëndësishme. Është përmirësuar dukshëm shpërndarja e shërbimeve në kohë dhe është lehtësuar qasja në rrjet.

Korniza ligjore për menaxhimin e tokës dhe të IKIH-së lehtëson zhvillimin e Administrimit të Tokës dhe të vetë IKIH-së në Republikën e Kosovës. Zhvillimet e IT-së në njërin anë dhe kërkesat e politikave të tregut të tokës nga ana tjetër kanë çuar në një situatë e cila ka bërë të mundur dhe të nevojshme që sistemet e të dhënave dhe proceseve të agjencive qeveritare të jenë gjithnjë e më të sinkronizuara. Qeveria dhe institucionet e saj gjithashtu kanë integruar portalet e internetit të

autoriteteve publike, në mënyrë që, deri në një farë niveli, për qytetarët të jetë në dispozicion zgjidhja e ashtuquajtur one-stop-shop. Për të realizuar këtë, janë hasur sfida serioze organizative.

Çdo vend bën zgjidhjen e vet, por themelorja për të gjitha zgjidhjet, është nevoja për një bashkëpunim të hapur dhe intensiv kompetencash të të gjithë autoriteteve qeveritare, dhe kjo është ajo që do të arrihet nëpërmjet IKIH-së në Kosovë.

Për më shumë, Agjencia Kadastrale e Kosovës duhet të azhurnojë edhe Strategjinë aktuale për IKIH, e cila u ndihmon institucioneve publike në Republikën e Kosovës që të krijojnë politikat e tyre për IKIH, konform kërkesave që dalin nga Rregulloret të BE-së.

Si ndihmesë në avancimin e Republikës së Kosovës në këtë fushë ka qenë edhe projekti IMPULS i përfunduar në fund të vitit 2019, që konsiston me harmonizimin e të dhënave gjeohapësinore të shteteve të regjionit me ato të shteteve anëtare të BE-së ndërsa mbështetëse e projektit ka qenë autoriteti suedez për kadastër dhe hartografi “Lantmateriet” dhe është financuar nga SIDA suedeze. Nëpërmjet përkrahjes së këtij projekti AKK-ja ka ngritur njohuritë profesionale për IKIH, dhe ka arritur të harmonizojë shumicën e të dhënave për të cilat është përgjegjëse, si dhe të ndihmojë disa institucione tjera prodhuese të të dhënave hapësinore të harmonizojnë të dhënat e tyre ekzistuese dhe krijimin e meta të dhënave për këto të dhëna.

7.1.3. Përdorimi i informatave nga sektorë të ndryshëm

Parimi i qasjes në të dhënat e administrimit të tokës për të gjithë u zbatua në disa vende evropiane. Në vitet 2000 u mundësua vizualizimi i kombinuar i gjeodatabazave nga disa burime (administrimi i tokës, planifikimi i përdorimit të tokës dhe të dhënat mjedisore). Informacioni mbi tokën duhet të hapet për përdoruesit e rinj të mundshëm. Organizatat si bankat ose kompanitë e sigurimeve nuk janë të trajnuar posaçërisht për të përdorur të gjitha përfitimet e mundshme të një kadastri. Trajnimi i tyre për të përdorur të dhëna kadastrale për menaxhimin e rrezikut mund të rrisë numrin e përdoruesve të të dhënave kadastrale.

Përparimi i aplikacioneve brenda dhe në kohë reale për teknologjinë moderne të komunikimit (Shërbime të Bazuara në Vendndodhje, e-Kadastri) mund të ndihmojë në mbajtjen e kadastrës në fokus publik.

Inovacioni nuk fillohet gjithmonë nga kërkesat e klientëve². Sigurisht, kërkesat dhe propozimet e klientëve duhet të merren parasysh, por ka edhe qasje dhe mundësi të tjera për t'u marrë në konsideratë.

7.1.4. Zhvillimet në administrimin e tokës në Evropë

Shërbimet e administrimit të tokës duhet të mbulojnë të gjitha të drejtat e pasurisë së paluajtshme (përfshirë kufizimet e vendosura mbi tokën dhe pasuritë e paluajtshme nga administrata publike). Deri më tani nuk ka asnjë burim qendror informacioni për pengesat e së drejtës publike në shtetet e Evropës qendrore.

² Henry Ford: “Nëse unë do t'i kisha pyetur njerëzit se çfarë duan, ata do të thoshin kuaj më të shpejtë”

Një pasqyrim gjithëpërfshirës kërkon informacione nga burime të ndryshme të ndjekura nga krahasimi dhe kombinimi i rezultateve.

Iniciativat siç është zbatimi i koncepteve mbi infrastrukturën e të dhënave hapësinore në shumë juridiksione arrijnë përparim të jashtëzakonshëm. Këto nisma zëvendësojnë qasjen e mëparshme të kadastrave me shumë qëllime. Numri i klientëve u rrit vazhdimisht. Në ditët e sotme spektri i përdoruesve varion nga institucionet publike (taksa e tokës), personat privat (sigurimi i pronësisë së tokës), institutet bankare (hipotekat), institucionet e planifikimit hapësinor (hartat në shkallë të gjerë), fermerët (subvencione bujqësore) dhe kompanitë e sigurimeve (përcaktimi i vlerës për pronën) etj.

Sistemet e administrimit të tokës kërkojnë zhvillim të vazhdueshëm i cili shpesh fillon nga inovacioni në teknologji dhe procese. Marketingu është një domosdoshmëri për ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me përfitimet nga të dhënat gjeohapësinore dhe të dhënave nga sektori i administrimit të tokës. Risetë e vazhdueshme formojnë një bazë të qëndrueshme për të garantuar sigurimin e informacionit të azhurnuar dhe të duhur mbi tokën për administratën publike, si dhe për biznesin privat.

7.2. ZHVILLIMET TEKNOLOGJIKE TË CILAT I REFEROHEN ADMINISTRIMIT TË TOKËS

Risetë e bazuara në proces me fokus në biznesin thelbësor duhet të bëjnë të mundur personalizimin dhe procedurat për shpërndarjen e produkteve të azhurnuara dhe shërbimeve në kohë reale (shih Direktivën INSPIRE dhe Agjendën Digjitale për Evropë). Zbatimi dhe optimizimi i proceseve ndër-organizative duke përdorur teknologjinë moderne të informacionit dhe komunikimit (TIK) mund të jetë një

alternative për bashkimin e organizatave. E-qeverisja siguron dhënien e shërbimeve të bazuara në ueb (rrjetin e internetit) në mes të qeverive dhe qytetarëve, në mes të qeverive dhe kompanive dhe përbrenda qeverisë.

Sistemi i administrimit të tokës duhet të përballojë trendin e aplikimit të biznesit duke ofruar shërbimet e tyre 24 orë 7 ditë në javë.

7.2.1. Integrimi i të dhënave

Në të ardhmen duhet të vazhdojë integrimi i më shumë grupeve të të dhënave kadastrale përmes parimeve të lidhjes së të dhënave. Kjo nënkupton disponueshmërinë e lidhjeve të mirëmbajtura mirë në mes të grupeve të të dhënave hapësinore dhe grupeve tjera “bazike” apo “kyçe” të të dhënave. Teknologjia për bazat e të dhënave të orientuara ndaj qëllimeve të planifikuara (Mature Object Oriented Database Technology) është në dispozicion ta përkrahë këtë, gjithashtu edhe si “open source (burim i hapur)”. Të dhënat duhen të jenë të sakta (me cilësi të ditur), autoritare (të pranuar nga qytetarët) dhe të siguruar. Gjithashtu fokusi duhet të jetë tek përmirësimi i mjeteve dhe standardeve ekzistuese për procesin e ndërlidhjes në mënyrë që të merren karakteristikat e informacionit kadastral dhe rritja e cilësisë, saktësisë së këtij procesi dhe mjetet ekzistuese.

7.2.2. Përkrahja e TIK-ut për proceset e administrimit të tokës

AKK-ja duhet të vazhdojë të azhurnojë strategji të veçanta dhe të specifikuar me një arkitekturë të mirë komunikimi dhe menaxhimi të të dhënave kadastrale dhe gjeohapësinore. Strategjia e AKK-së për IT dhe plani i implementimit të dorëzuar në muajin prill 2017, është një dokument i dizajnuar dhe i pranuar si dokument. Kjo strategji është e bazuar edhe në synimet e AKK-së nga periudha e kaluar, e që

në këtë plan strategjik janë të përfshira dhe të azhurnuara në kuptimin e rritjes së numrit të shërbimeve, cilësisë së atyre shërbimeve si vlerë e shtuar e AKK-së.

E-Portali shtetëror është një sportel elektronik nga ku qytetari përmes internetit mund të marrë shërbimin elektronik nga qeveria. Në e-Portal vazhdimisht do të vendosen shërbime të reja elektronike, sapo qeveria këto shërbime t'i bëjë elektronike. Realizimi dhe plotësimi i vazhdueshëm me shërbime elektronike i e-Portalit shtetëror është me rëndësi parësore për një administratë publike moderne. Të gjitha pengesat burokratike të administratës do të eliminohen me ofrimin e shërbimeve administrative përmes e-Portalit shtetëror apo e-nënportaleve. Pritjet para sporteleve të zyrave administrative, si në nivel qendror dhe atë lokal do të eliminohen.

Në AKK të gjitha ndryshimet bëhen përmes SIKTK-së, i ndërtuar mbi të dhëna të shumta që mundëson Regjistri Kadastral. Shfrytëzuesit përmes kartelave elektronike të identifikimi (e-ID), do të kenë mundësi të qasen në njësitë e tyre kadastrale, për të marrë informacionin e dëshiruar apo për të realizuar shërbimin që dëshirojnë rreth atyre njësive kadastrale. Shërbime të tilla integrohen në e-Portalin shtetëror, në mënyrë që shfrytëzuesit e këtyre shërbimeve të mund të shërbehen nga një sportel i vetëm me të gjitha shërbimet elektronike të mundshme.

Krijimi i ueb shërbimeve dhe e-shërbimeve është një mundësi e cila është duke u shfrytëzuar nga AKK-ja, e në interes të shfrytëzuesve të të dhënave. AKK-ja ka krijuar një varg aplikacionesh për administrim, mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e të dhënave si Gjeoportalin Shtetëror, Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK pjesën tekstuale dhe grafike), aplikacionin për informacione të sistemit të adresave (ARIS), Aplikacionin për administrimin dhe indeksimin e Dokumenteve të Skanuara Kadastrale, dhe për shumicën e produkteve janë krijuar ueb shërbime. Me krijimin e mundësisë së nënshkrimit dhe vulës elektronike, AKK-ja do të jetë e gatshme të krijojë e-shërbime, po ashtu

të krijojë një “one stop shop” ku të gjithë shfrytëzuesit do të mund të marrin produktet pronësore dhe kadastrale në ueb.

Zbatimi i strategjisë së IT-së mundëson avancimin e proceseve të dorëzimit të të dhënave të përpunuara të jashtme dhe regjistrimit të pronës në SIKTK. Siguria e të dhënave do të jetë edhe më e madhe kur të mundësohet qasja online për gjeodetët e licencuar, noterët, avokatët, përmbaruesit, ndërmjetësuesit si dhe institucione tjera si gjykatat, prokuroria dhe agjencitë të ndryshme. Të gjitha këto grupe të interesit mund të shënojnë informacione të rëndësishme të autorizuara lidhur me pronën në mënyrë që të eliminohet mundësia e çfarëdo abuzimi lidhur me të drejtat e pronës.

Sot furnizimi me informata është i organizuar përmes portaleve. Kjo kërkon që qytetarët të kenë në dispozicion qasjen në internet. Mund të bëhet një vështirësi këtu se përdoruesit e thjeshtë gjithnjë e më shumë janë duke u shndërruar në përdorues që kanë dituri në TI, kjo lë të kuptohet se përdoruesit presin të dhëna kualitative. Përdoruesit nuk janë të interesuar në atë se si është i organizuar furnizimi me informata, ata kryesisht janë të interesuar në vetë të dhënat. Të dhënat duhen të jenë të sakta (me cilësi të ditur), autoritare (të pranuar nga qytetarët) dhe të siguruar.

Imazhet satelitore dhe ortofotot mund të ndërlidhen me shtresa tjera të infrastrukturës së gjeoinformatave për vendimmarrje në shumë fusha (p.sh. menaxhimi i fatkeqësive, transportit, planifikimit hapësinor). Lloje të reja të marrëdhënieve ndërmjet njeriut dhe tokës do të zhvillohen me kalimin e kohës për planifikimin hapësinor, për implementimin e planeve hapësinore (status i përkohshëm) dhe për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e zonave pas implementimit (duke përfshirë zhvillimet e mëtejshme). Sistemet duhet të dizajnohen që të përkrahin këtë zhvillim.

Plani Strategjik 2021-2025 dhe Plani i Biznesit dhe i Veprimit 2021-2023+,

adresojnë edhe çështjen e interoperabilitetit duke e zhvilluar një ndërveprim të sistemeve dhe shërbimeve elektronike në mes institucioneve. Kjo duhet të bëhet në kuadër të një kornize e cila do të ndihmojë arritjen e këtij ndërveprimi të sistemeve, shërbimeve elektronike dhe arkitekturës së teknologjisë së informacionit. Hartimi i kornizave kombëtare të Interoperabilitetit është edhe një rekomandim që del nga Korniza e interoperabilitetit pan-Evropian dhe kjo do të përgatisë Kosovën për ndërveprimet e sistemeve dhe shërbimeve elektronike të saj me ato të vendeve të ndryshme të BE-së.

7.2.3. Standardet e hapura

Standardet e hapura e përkrahin organizimin e të dhënave hapësinore dhe qasjen në to, ndërveprimin, transformimet etj. Seritë ISO 19000 (ISO 19101 deri ISO 19162) mbulojnë fushat e informacionit gjeografik digjital (siç është përdorur nga sistemet e informacionit gjeografik) dhe gjeomatika. Seria ISO 19000 mirëmbahet nga ISO / TC 211 dhe puna është e lidhur ngushtë me përpjekjet e Konsorciumit të Hapur Gjeohapësinor. Ai përbëhet nga më shumë se 60 dokumente. ISO 19101-1: 2014 përcakton modelin e referencës për standardizimin në fushën e informacionit gjeografik. Ky model referimi përshkruan nocionin e ndërveprimit dhe përcakton bazat me të cilat bëhet ky standardizim. ISO 19152: 2012, Informacioni gjeografik - Modeli i Domenit të Administrimit të Tokës (LADM).

Softueri i hapur është në dispozicion në sistemet e menaxhimit të bazave të të dhënave dhe sistemet e informatave gjeografike si dhe në platforma. Organizatat si ajo për Ushqim dhe Bujqësi e Kombeve të Bashkuara (OUB/FAO) janë përkrahëse dhe në ndërkohë softueri i hapur është zhvilluar në një burim profesional dhe të qëndrueshëm për zhvillimin e sistemeve të TI-së.

Të dhënat Open Source (me kod të hapur) janë vënë në dispozicion nëpër aplikacione si Google Earth, Virtual Earth, WikiMapia, OpenStreetMap, etj.

Shumë shitës ofrojnë imazhe vizuale. Lokacionet e gjeo-referuara në këto mjedise “open source” të të dhënave të cilat duhet të kombinohen me harta topografike dhe kadastrale të qeverisë për të arritur deri te një infrastrukturë gjithëpërfshirëse e gjeo informatave publike dhe private të drejtuara kah konsumatori.

7.3. NGRITJA E KAPACITETEVE

Paralelisht me operimet e përditshme, stafi brenda AKK-së duhet të ekzekutojë një numër projektesh të ndryshme. Kjo imponon një staf shtesë që të realizohen aktivitetet shtesë dhe të përmirësohet performanca operative. Aktualisht në sektorin publik janë të punësuar gjithsej 428 punëtor prej tyre në ZKK 361, ndërsa në AKK janë gjithsej 52 punëtor të aprovuar nga buxheti i Kosovës, ndërsa 7 të tjerë janë të angazhuar me projekte. Numri mesatar i stafit për një milion banorë, për institucionet e administrimit të tokës në rajon është rreth 410 punëtorë. Nëse kjo mesatare do të aplikohet në Kosove numri i stafit të AKK-së dhe ZKK-ve do të arrinte rreth 900 punëtorë.

Përfshirja e sektorit privat është parë se sjell shumë përfitim në zhvillimin e sektorit të administrimit të tokës. Deri më tani janë licencuar 131 gjeodet, 25 teknik të gjeodezisë dhe 25 kompani gjeodete për matje gjeodezike, të cilat kanë autorizime të kryejnë aktivitete kadastrale në tërë territorin e Kosovës. Nga fundi i vitit 2019, matjet kadastrale u janë përcaktuar si detyrë ekskluzive gjeodetëve dhe kompanive të licencuara gjeodete, duke ua hequr një barrë ZKK-ve. Universitetet dhe institutet e arsimit, në nivelin global, janë duke zhvilluar kurrikula të reja që të arsimojnë specialistët e ardhshëm në administrim të tokës, kadastrit dhe të

gjeoinformatave. Profesionet ekzistuese siç janë gjeodetët, noterët dhe personat e autorizuar për shitjen e patundshmërisë ndikohen shumë nga teknologjia dhe zhvillimet ndërkombëtare. Komisioni Evropian për këtë arsye mbështetë fuqishëm programet e mësimi gjatë gjithë jetës për profesionistët. Pritet që në të ardhmen e afërt marrëdhëniet në mes të punëtorëve në sektorin e administrimit të tokës dhe universiteteve apo instituteve të arsimit të forcohen. Gjithashtu në këtë fushë, mund të priten modele të reja bashkëpunimi.

Në Evropë është parë se aspektet gjeodezike janë zgjidhur në bashkëpunim të mirë në mes të sektorit privat dhe palëve qeveritare. Regjistri i tokës, kadastri dhe agjencitë hartografike të nivelit qendror të qeverisë janë shpesh herë përgjegjëse për definimin e infrastrukturës teknike, standardeve, procedurave të punës, kompetencave personale, ligjore dhe teknike si dhe për kontrollin e cilësisë. Gjeodetët në sektorin privat shpesh herë punësohen në bazë të kontratave kornizë (standardet, kualiteti, kostot, afatet kohore) për ekzekutimin e punëve praktike.

Praktika e bashkëpunimit në mes të AKK-së, ZKK-ve dhe sektorit privat të gjeodetëve ekziston dhe do të zhvillohet më tutje. Me implikimet teknike që janë duke u zhvilluar shpejt në profesionin e gjeodetëve (qeveritar dhe privat), krijohen parakushte për transmetim të dijes dhe përvojave, qoftë përmes konsulencave apo trajnimeve për ngritje të kapaciteteve profesionale edhe në vendet të tjera në zhvillim.

8. ÇËSHTJET KRYESORE STRATEGJIKE

Qeveria e Republikës së Kosovës përmes organeve të saja të përcaktuara për të administruar tokën, kadastrën, regjistrat pronësorë, gjeoinformacionin, IKIH etj., duhet të jetë e fokusuar në zhvillimin paralel të dy aspekteve të administrimit të tokës siç janë aspekti profesional dhe teknologjik, si dhe aspekti gjithëpërfshirës. Përmes zhvillimit profesional dhe teknologjik, do të avancohej dhe mirëmbahej infrastruktura e administrimit të tokës në mënyrë cilësore, ndërsa aspekti i gjithëpërfshirjes do të garantonte që përfitues nga një tokë e administruar mirë të jenë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, pa marrë parasysh përkatësinë gjinore, etnike, fetare etj. Në këtë drejtim Agjencia Kadastrale duhet të jetë e angazhuar në zhvillimin e mëtutjeshëm të këtyre aspekteve të administrimit të tokës të cilat ndërlidhen kryesisht me kadastrin, regjistrimin e pronës, gjeoinformacionin dhe IKIH-në. Nga këto zhvillime rrjedhin edhe Objektivat Strategjike të shtjelluar në këtë Strategji dhe Plan Biznesi. Në aspektin e zhvillimeve të administrimit të tokës duhet pasur parasysh çështjet strategjike në vijim:

8.1. REFORMA LIGJORE

Reforma ligjore përfshin ligjet bazike të funksionimit të AKK-së (Projekt ligji për kadastrë dhe projektligji për Infrastrukturën Kombëtare të Informacioneve Hapësinore), Udhëzimet Administrative, Kornizat Ligjore për punë teknike si dhe rregullore përkatëse, për të zhvilluar më tej një sistem efektiv për regjistrimin e pronësisë mbi tokën, vlerën dhe përdorimin e tokës, për një operim efikas të ekonomisë së tregut dhe përforcim në menaxhimin e qëndrueshëm dhe produktiv të burimeve tokësore. Institucionet të cilat merren me administrimin e tokës janë

efikase dhe me ndikim të konsiderueshëm mbi standardet e zhvillimit social dhe ekonomik të vendit. Duhet patur parasysh që të krijohen mekanizma kontrolli efektiv në krijimin dhe zbatimin e politikave për arritjen e cilësisë për të siguruar përgjegjësi të nevojshme, qëndrueshmëri dhe mbështetje të interesave shtetërore, komunale dhe interesave të sektorit privat, dhe përpjekjeve të organizatave të përfaqësimit shtetëror e ndërkombëtarë (në cilësinë e donatorëve), si dhe shoqata e organizata joqeveritare

8.2. ZHVILLIMI DHE MODERNIZIMI I KADASTRIT

Zhvillimi i Kadastrit përfshin shtrirjen e përgjegjësisë së AKK-së për të mbuluar të gjitha proceset në lidhje me regjistrimin e pronës së paluajtshme, shërbimet kadastrale, mbledhjen e të dhënave, mirëmbajtjen dhe furnizimin e informacionit. Për një menaxhim ditor të ZKK-ve, është i nevojshëm kapaciteti për mbledhjen, mirëmbajtjen dhe furnizimin me të dhëna nga ZKK-ja dhe aftësia për të menaxhuar (mbështetur dhe mirëmbajtur) të gjitha sistemet, proceset dhe shërbimet e ZKK-ve.

Procesi i regjistrimit të pronës është duke u bërë më kompleks për shkak të rritjes së popullatës dhe tendencat për një zhvillim vertikal të mjedisit urban. Ndërtesat e larta, infrastruktura mbështetëse, përvojat imponojnë që të merret në konsideratë paraqitja e objekteve në 3D.

Afati kohor i kësaj strategjie për zhvillimin e mëtutjeshëm të kadastrit mund të krijojë një fillim të mbarë i cili identifikon një perspektivë të nevojshme për të ardhmen.

8.3. PUNËT THEMELORE GJEODEZIKE

AKK është gjithashtu përgjegjëse për të gjitha çështjet në lidhje me punët themelore gjeodezike. Të gjitha matjet për punë gjeodezike apo azhurnim të të dhënave kadastrale duhet të bëhen nga rrjeti permanent gjeodezik i rendit I,II dhe III të bazuar në sistemin referent gjeodezik shtetëror Kosovaref01. Rrjeti gjeodezik Kosovaref01 është homogjen dhe shtrihet në tërë territorin e Kosovës. Ky rrjet është i mbështetur në pikat permanente të njohura të rrjetit EUREF (Itali, Kroaci, Austri dhe Greqi). Gjithashtu matjet për punë themelore gjeodezike apo azhurnim të të dhënave kadastrale, bëhen edhe nga Sistemi i pozicionimit në Kosovë – KOPOS, i cili është rrjet shtetëror unik me saktësi të pozitës në kohë reale. KOPOS përbëhet nga gjithsej 8 stacione permanente të cilat mbulojnë gjithë territorin e Republikës së Kosovës

Për më tepër AKK është përgjegjëse për zhvillimin dhe përcaktimin e rrjetit gravimetrik, i cili mundëson një vlerësim të qartë dhe real nga ana e përdoruesve të ndryshëm të të dhënave për gravitetin në pikat e ndryshme të territorit të vendit, gjithashtu është në funksion të Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës.

Rrjeti i nivelimit është në funksion të përcaktimit të kriterëve teknike bazë për kontrollin gjeodezik vertikal në Kosovë.

8.4. TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE INFRASTRUKTURA GJEOPHAPËSINORE

Qeverisja e TI-së duhet të sigurojë që të dhënat dhe informacioni që organizatës i duhet për të përmbushur objektivat e biznesit të tij janë lehtësisht të disponueshme në një kohë dhe të sigurt përmes proceseve efektive e efikase dhe përdorimit të aplikacioneve dhe teknologjisë së duhur.

Gjatë periudhës pesë vjeçare të aplikimit të kësaj strategjie, parashikohet të ketë disa ndryshime domethënëse (legjislacion, përparime në teknologji) të cilat do të ndikojnë në mënyrën e funksionimit të AKK-së dhe të cilat do të kërkojnë azhurnim në strategjinë e re të TI-së, ose të japin disa aspekte tek strategjia aktuale e TI-së. Prandaj, kjo strategji e TI-së nuk ka për qëllim të jetë një dokument statik por duhet të evoluojë. Strategjia duhet të rishikohet të paktën çdo vit, me ndryshime dhe azhurnime të bëra, siç kërkohet, për të përmbushur kërkesat në zhvillim të organizatës dhe për të mbajtur krah për krah zhvillimeve në teknologji.

Pasi AKK është përgjegjëse për përcaktimin e politikave dhe rregulloreve në nivel kombëtar, përfshirë krijimin e udhëzimeve administrative në lidhje me fushat e përgjegjësisë së saj, kjo gjithashtu duhet të zgjerohet për të përfshirë politikën për krijimin e të dhënave gjeohapësinore brenda Kosovës sipas strategjisë dhe projektligjit për IKIH.

8.5. RI-ORGANIZIMI I KADASTRIT DHE VETË-FINANCIMI

AKK-ja duhet të marr mandatin e vet nga Qeveria e Kosovës përmes njëres nga Ministrinë apo të jetë sipas ligjit të ri nën ombrellën e Zyrës së Kryeministrit (modeli i Maqedonisë Veriore). Mandati duhet të definohet qartë në ligje dhe udhëzime administrative përmes së cilave paraqitet misioni i gjithmbarshëm i AKK-së dhe fushat e kompetencës.

Agjencia Kadastrale në kompetencën e vet parashihet të menaxhojë edhe Infrastruktura Kombëtare të Informacioneve Hapësinore dhe përgjegjësi të tjera të cilat do të mbulohen në strukturën e re organizative e cila me të gjitha specifikat e veta do të trajtohet me institucionin mbikëqyrës dhe grupe të interesit.

Organizimi vertikal i kadastrës së Kosovës, do të reflektojë ndryshime edhe në strukturën dhe funksionimin e ZKK-ve të cilat duhet ta ruajnë misionin e gjertanishëm duke e avancuar atë edhe me elemente të tjera të cilat do të përcaktohen nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, si autoritet qendrorë për realizimin e misionit të saj.

Aktualisht, AKK-ja është financuar kryesisht përmes Qeverisë së Kosovës dhe Marrëveshjeve të Kredive dhe Granteve (CGA) përmes Agjencive Ndërkombëtare të Zhvillimit (IDA), siç është Banka Botërore.

Nga përvojat e shteteve të rajonit dhe më gjerë është vërtetuar se ky model i financimit nuk është i qëndrueshëm dhe se, për t'u bërë një organizatë e qëndrueshme, AKK-ja duhet të zhvillojë burimet e veta të financimit. Projektligjet që janë aktualisht në shqyrtim, lejojnë që kjo të ndodhë me planin për një lëvizje graduale në një model operimi të vetë-financimit në të ardhmen e afërt.

Sipas legjislacionit të ri, AKK-ja do të jetë përgjegjëse për të dhënat për menaxhimin e ZKK-ve dhe kështu krijohet një funksion i ri i biznesit të menaxhimit të ZKK-ve.

Një tjetër funksion i ri i biznesit për AKK-në përfshin zhvillimin e produkteve të reja dhe inovacionin. Ky funksion ka për qëllim për të kuptuar kërkesat e palëve të interesit dhe të tregut për të dhënat kadastrale dhe zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve për të përmbushur atë kërkesë.

8.6. E-QEVERISJA

E-qeverisja është një shtytës kryesor për AKK-në. E-kadastrë duhet të lehtësojë shërbimet më të gjëra të e-qeverisjes përmes sigurimit të një platforme të bazuar në të dhënat kadastrale (Government to Government -G2G).

Strategjia e Qeverisjes Elektronike 2009-2015, krijuar nga Agjencia për Shoqërinë e Informacionit (ASHI), jep udhëzime për përdorimin e pajisjeve të standardizuara, softuerëve, bazave të të dhënave, rrjeteve dhe ofrimit të shërbimeve të internetit dhe sigurisë.

8.7. NDËRTIMI I KAPACITETEVE

Zhvillimet në teknologji, rregullat dhe standardet, siç është ISO 19158 Informacioni Gjeografik - Sigurimi i cilësisë së furnizimit të të dhënave, mund të ndihmojnë në vendosjen e mekanizmave të menaxhimit të cilësisë.

Për të menaxhuar ZKK-në, AKK-ja do të duhet të sigurojë që ka kapacitetin dhe aftësinë. Funkcioni i biznesit të menaxhimit të ZKK-së do t'i sigurojë AKK-së aftësi për të menaxhuar dhe operuar në mënyrë efektive ZKK-të. Funkcioni i menaxhimit të biznesit të ZKK-së do të sigurojë aftësinë njerëzore për të menaxhuar punonjësit e ZKK-së dhe të mbështesë ata që janë përgjegjës për krijimin dhe azhurnimin e të dhënave kadastrale, përfshirë një linjë ndihme të përkushtuar.

Funksioni i menaxhimit të biznesit të ZKK-së do t'i sigurojë AKK-së aftësinë teknike për të menaxhuar mbledhjen, mirëmbajtjen dhe furnizimin e të dhënave kadastrale nga ZKK-të. Furnizimi i të dhënave tashmë është trajtuar përmes Sistemit të Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë, megjithatë AKK-ja do të duhet të zhvillojë aftësinë për të krijuar dhe menaxhuar detyra në kuadër të ZKK-ve. AKK gjithashtu do të duhet të zhvillojë aftësinë dhe kapacitetin e sistemeve, proceseve dhe shërbimeve të ZKK-ve, dhe të krijojë një udhëzues për të mbështetur pyetjet teknike nga ZKK-të.

8.8. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Menaxhimi, është një tërësi mjjetesh dhe procesesh, rezultatet e të cilave sjellin një kënaqësi dhe përmirësim i vazhdueshëm. Përmirësimi i vazhdueshëm paraqet një proces i cili nënkupton që përmirësimi të jetë pjesë e tërësishme e veprimit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Kjo përfshinë sigurimin e kërkesave dhe nevojave të shfrytëzuesve, përmes proceseve adekuate.

Kapaciteti i referohet aftësisë së organizatës për të siguruar numër të mjaftueshëm të stafit për të realizuar proceset e saj të punës dhe për të ofruar me sukses produkte për klientët duke përfshirë aftësinë për të përmbushur numrin e kërkesës për projekte të ndryshme.

AKK-ja ka një fuqi punëtore ekuivalente me 56 të punësuar me orar të plotë dhe me mesatare të moshës rreth 41 vjeçare, pra një organizatë relativisht e re dhe vitale. Më shumë se gjysma e stafit kanë diplomë universitare dhe ka një proporcion të shkëlqyeshëm gjinor, rreth 2/3-ve të gjinisë femërore.

Sipas të dhënave të AKK-së, vlerësimet vjetore të performancës tregojnë rezultate të kënaqshme të kualitetit të performancës së stafit, në AKK, dhe ky kualitet duhet të përmirësohet në vazhdimësi. Nga raportet e monitorimit të ZKK-ve shihet që kualiteti i performancës së stafit nëpër shumicën e ZKK-ve nuk është në nivelin e duhur të kënaqshmërisë.

Sipas të dhënave të pranuara, AKK-ja dhe shumica e ZKK-ve kanë disa plane vjetore të cilat përmbajnë burimet njerëzore që nevojiten, por nuk ka një plan afatgjatë për ngritjen e kapaciteteve të ndërlidhur me pozitat, në të ardhmen. Planet vjetore janë bazë për raportimet periodike për qeverinë.

Është adresuar nevoja për trajnim të aftësive menaxhuese dhe të biznesit, punëtorët e AKK-së shpesh marrin pjesë në punëtori dhe konferenca ndërkombëtare, si

pjesëmarrës e po ashtu edhe si kontribues. Një program trajnimi për fushat e veprimit të AKK-së dhe ZKK-së do të fillojë menjëherë pas miratimit të dy ligjeve. Institucionet e edukimit në mënyrë aktive do të jenë burim i kuadrove të nevojshme, ku në kuadër të AKK ka shprehë mundësinë e bashkëpunimit me Universitete, me çrast do të merreshin iniciativa për avancime cilësore, apo ndryshim të kurrikulave të cilat do ti përshtaten kërkesave të tregut të punës.

8.9. ZHVILLIMI I PRODUKTEVE DHE INOVACIONI (ORIENTIMI DREJT KONSUMATORIT)

Për të zhvilluar një kadastër gjithëpërfshirës, përmes së cilës mbështet agjenda më e gjerë e qeverisë dhe zhvillimi i shërbimeve për qytetarët, AKK duhet të zhvillojë produkte dhe shërbime inovative që plotësojnë kërkesat e qeverisë dhe qytetarit. Për më tepër, nëse AKK do të bëhet një organizatë plotësisht e vetë-financuar, duhet të zhvillohen produkte dhe shërbime inovative që plotësojnë kërkesat specifike të tregut të cilat mundësojnë shtimin e vlerës bazuar në të dhënat kadastrale.

Palët e interesit do të përfshijnë gjithashtu palët jo-tradicionale, të tilla si kompanitë e sigurimeve ose organizatat tjera të sektorit privat, të cilat nëse plotësohen kërkesat e tyre për të dhëna, mund të jenë të gatshëm të paguajnë për licencë ose blerje të të dhënave, ose të zhvillojnë aplikacione dhe shërbime që krijojnë të hyra për AKK.

8.10. MENAXHIMI I CILËSISË

Rekomandohet që AKK të ndryshojë procesin e saj aktual të kontrollit të cilësisë. Në vend të kontrolleve periodike të cilësisë, të cilat bëjnë pak për të përmirësuar cilësinë e përgjithshme të të dhënave kadastrale, AKK duhet të implementojë një

qasje të menaxhimit të cilësisë. Menaxhimi i cilësisë përbëhet nga kontrolli i cilësisë dhe sigurimi i cilësisë. Në terma themelor, kontrolli i cilësisë është i përqendruar në produkt dhe sigurimi i cilësisë është i përqendruar në proces. Kontrolli i cilësisë teston prodhimin e një procesi për të siguruar që rezultatet janë ashtu siç priten. Sigurimi i cilësisë siguron që procesi po prodhon rezultatin e duhur. Siguron që elementet e procesit janë duke bërë gjënë e duhur, në kohën e duhur, në përputhje me politikat e sakta duke përdorur standardet e duhura.

8.11. ÇËSHTJET E NDËRLIDHURA

Qeveria ka hartuar strategji, të cilat ndërlidhin politikat zbatuese të fushave specifike në përputhje me normat e përgjithshme, sa i përket zbutjes së varfërisë, mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve, mbrojtja e mjedisit dhe luftimi i korrupsionit. Qeveria në strategjitë, planet e veprimit dhe planin e biznesit të Qeverisë ka rekomanduar masat ndaj këtyre çështjeve. Është detyrim ligjor dhe kushtetues që edhe në këtë strategji të merren parasysh çështjet të cilat kanë të bëjnë me aspektin e të drejtave njerëzore.

8.11.1. Masat kundër korrupsionit

Transparenca dhe saktësia e të dhënave mund të konsiderohen si të rëndësishme në parandalimin e mundësive për korrupsion. Ky plan biznesi sugjeron indikatorë të qartë besueshmërie për të dhënat kadastrale dhe për regjistrimin e të drejtave të pronës i cili konfirmon principet kundër korrupsionit dhe diskriminimit. Zbatimi i procedurave administrative, ka paraparë mundësinë e rishikimit të vendimeve të nxjerra në ZKK, në funksion të saktësisë së vendim marrjes. Infrastruktura e

arritur në disa zyra kadastrale të rinovuara në zbatim të projektit të ri-inzhinjerimit, i financuar nga Banka Botërore është një hap tjetër i krijimit të kushteve të cilat gjithashtu eliminojnë rrezikun nga korrupsioni. Pagat në sektorin publik ende konsiderohen të ulëta, e që mundën me qenë burim i korrupsionit. Biznes Planit sugjeron që Qeveria të zhvillojë një plan për pagat e ekspertëve në AKK, të kyçur në aktivitete kryesore, si kadastër, të drejtat mbi pronën e paluajtshme, punët themelore gjeodezike, IKIH dhe hartografi. Bashkëpunimi i përhershëm me Avokatin e Popullit dhe agjencitë të tjera që ndërlidhen me veprimtarinë e AKK-së, konsiderohet si masë parandaluese e korrupsionit.

8.11.2. Barazia gjinore dhe të drejtat e minoriteteve

Ndryshimet në teknologji kanë kontribuar në qeverisje më të mirë të zotërimit të tokës nëpërmjet shërbimeve të përmirësuara që nga efikasiteti, transparenca, mundësitë e limituara për korrupsion, llogaridhënia, qasja, barazia dhe perspektiva e shpenzimeve që i bënë këto shërbime më të përballueshme për të gjithë. Qasjet inovative të zbatuara për të dhënat e tokës mund rrisin qasjen e të dhënave relevante gjinore në nivel kombëtar. Kjo mund të jetë bazë për përmirësim të vazhdueshëm të politikave gjinore në kontekstin e të drejtave trashëgimore dhe biznesore. Legjislacioni në Kosovë është një bazë e qëndrueshme në sigurimin e barazisë gjinore në lidhje me të drejtat pronësore. Zbatimi i monitoruar i strategjive përkitazi me të drejtat e pronës, konsiston edhe me mbrojtjen dhe sigurinë e të drejtave të minoriteteve me të gjitha specifikat e veta tek trashëgimitë dhe regjistrimit të të drejtave reale të pronës.

9. PLANI FINANCIAR

9.1. VLERËSIMI I KOSTOVE DHE FINANCIMI I TANISHËM

9.1.1. Buxheti i AKK-së për vitin 2020

Nga tabela më poshtë shihet që për vitin 2020 të hyrat për vitin 2020 janë 1,808,089 Euro, prej tyre nga granti qeveritar janë 1,708,089 Euro kurse financimi nga huamarrja 100,000 Euro.

Burimet e Financimit	Të punësuarit në vitin 2020	Paga dhe Shtesa €	Mallërat dhe Shërbimet €	Shpenzimet komunale	Shpenzimet Kapitale	Shpenz. 2020 Total €	Vlerës. 2021 Total €	Vlerës. 2022 Total €
	52	368,739	815,000	9,350	615,000	1,808,089	1,865,089	1,458,089
Grantet Qeveritare		368,739	715,000	9,350	615,000	1,708,089	1,765,089	1,358,089
Të Hyrat vetanake		0	0		0	0		
Financimi nga Huamarrja		0	100,000		0	100,000		
Të Hyrat nga AKP		0	0		0	0		

Burimi: Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020

Tabela 1. Buxheti i AKK-së nga granti qeveritar

Nga investimet kapitale sipas klauzolës së investimeve për vitin 2020 janë të planifikuara 3,162,000 Euro.

Burimet e Financimit	Shpenzimet Kapitale	Shpenz. 2020 Total:	Vlerës. 2021 Total:	Vlerës. 2022 Total:
Klauzola e Investimeve	3,162,000€	3,162,000€	3,800,000€	215,000€

Burimi: Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020

Tabela 2. Buxheti i AKK-së nga klauzola e investimeve

9.1.2. Shpenzimet e AKK-së

Në bazë të raportit të ekzekutimit të buxhetit shihet që në vitin 2018 AKK ka pasur shpenzime më të vogla se sa në vitet paraprake nga 2013 deri në 2017. Kjo për shkak të burimeve financiare të cilat kanë qenë mjete nga donatorët të cilat janë shpenzuar në kuadër të investimeve kapitale. Gjithashtu, në vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016 kemi pasur edhe të hyra nga huamarrja të cilat kryesisht janë shpenzuar për investime kapitale.

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme për (AKK)

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor

	2018	2017	2016	2015	2014	2013
	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit
BURIMET E FONDEVE						
Granti qeveritar	1,484,677.00	778,014.00	794,115.00	886,389.89	752,166.71	909,632.42
Të hyrat vetanake						
Të hyrat e dedikuara						
Grantet e përcaktuara të donatorëve	41,568.00	924,482.00	1,287,529.00	469,901.94	380,294.93	531,367.27
Huamarrjet			453,718.00	1,107,331.55	1,434,977.10	1,222,310.73
Fondi zhvillimor në mirëbesim						
Pranimet tjera						
Gjithsej	1,526,245.00	1,702,496.00	2,535,362.00	2,463,623.38	2,567,438.74	2,663,310.42

SHFRYTËZIMI I FONDEVE

Operacionet						
Paga dhe mëditje	373,812.0 0	371,247.00	371,839.00	352,37 1.4 4	297,519.0 8	302,252.11
Mallra dhe shërbime	149,100.0 0	591,057.00	499,838.00	573,14 0.6 3	444,843.8 6	436,801.06
Shpenzime komunale	4,340.0 0	4,152.0 0	4,023.0 0	4,555.2 1	6,779.2 6	6,976.54
	527,252.00	966,456.00	875,710.00	930,067.2 8	749,142.2 0	746,029.71
Transferet						
Transfere dhe subvencione						
Shpenzime kapitale	998,993.00	736,041.00	1,639,652.00	1,533,555.10	1,818,296.55	1,917,280.71
Prona, ndërtesa dhe pajisje						
Kthim i huamarrjeve						
Pagesa tjera						
Gjithsej	1,526,245.00	1,702,497.00	2,535,362.00	2,463,622.38	2,567,438.75	2,663,310.42

Tabela 3. Pasqyra e shpenzimeve të AKK sipas viteve (të shprehura në euro)

9.1.3. Analizimi i pagave dhe mëditjeve

Kodi për paga dhe mëditje burim të financimit ka grantin qeveritar. Nga viti 2014 AKK ka pasur rritje të konsiderueshme për dallim nga viti 2013, ku ky trend i rritjes së shpenzimeve për paga dhe mëditje ka vazhduar në vitin 2015, për të pasur një rritje më të vogël në vitin 2016 dhe një rënie në vitin 2017. Mesatarja e rritjes së pagave prej vitit 2013 deri në vitin 2018 është 7%.

Përshkrimi	2018 €	2017 €	2016 €	2015 €	2014 €	2013 €
Paga neto përmes listës së pagave	318,229.00	316,445.00	317,122.00	299,971.00	254,443.00	221,586.00
Pagesa për sindikatë						
Pagesa neto për jashtë orarit						
Punëtorët me kontratë (jo në listën e pagave)						
Tatimi ndaluar në të ardhura personale	19,982.00	19,445.00	19,321.00	18,840.00	14,739.00	11,537.00
Kontributi pensional-punëtori	17,801.00	17,678.00	17,708.00	16,780.00	14,168.00	12,269.00
Kontributi pensional-punëdhënësi	17,801.00	17,678.00	17,708.00	16,780.00	14,168.00	12,268.00
Paga dhe mëditje	373,813.00	371,246.00	371,859.00	352,371.00	297,518.00	257,660.00
Diferenca mes viteve	2,567.00	(613.00)	19,488.00	54,853.00	39,858.00	
Përqindja e rritjes nga viti në vit	0.7%	-0.2%	5.2%	15.6%	13.4%	

Tabela 4. Paga dhe mëditje 2013-2018 (të shprehura në euro)

Trendi i rritjes së shpenzimeve për paga dhe mëditje




Figura 2. Trendi i rritjes së shpenzimeve për paga dhe mëditje 2014-2018

9.1.4. Të hyrat e AKK-së

Në kuadër të të hyrave AKK ka disa burime. Përveç grantit qeveritar i cili është edhe baza kryesore e financimit, janë edhe të hyrat jo tatimore, të hyrat nga donatorët dhe të hyrat nga huamarrja.

Të hyrat jo tatimore, përbëhen nga të hyrat nga licencat dhe të hyrat nga shitja e produkteve dhe shërbimeve, që përbëjnë pjesën më të madhe të të hyrave vetanake.

	2018 €	2017 €	2016 €	2015 €	2014 €	2013 €
Të hyrat nga taksat 1						
Të hyrat nga taksat 2						
Të hyrat nga dënimet-gjobat 1						
Të hyrat nga dënimet-gjobat 2						
Të hyrat nga licencat 1	5,550.00	3,900.00	9,450.00	7,650.00	9,900.00	8,250.00
Të hyrat nga licencat 2						
Të hyrat nga shitja e pasurisë dhe shërbimeve	91,782.00	69,325.00	71,482.00	10,896.00	137,982.00	17,214.00
Të hyrat nga inspektimi						
Të hyrat nga interesi bankar						
Të hyrat nga ndryshimet e pozicionit të kursit						
Pranimet tjera						
Gjithsej	97,332.00	73,225.00	80,932.00	18,546.00	147,882.00	25,464.00

Tabela 5. Të hyrat jo tatimore (të shprehura në euro)

Të hyrat nga donatorët janë të hyra që sigurohen nga organizatat e huaja ndërkombëtare dhe kanë një kohë të caktuar dhe kushte të veçanta për ti shfrytëzuar.

			2018 €	2017 €	2016 €	2015 €	2014 €	2013 €
Banka Botërore	94110	RECAP Projekt	169,966.00	796,084.00	1,421,699.00	471,433.00	380,295.00	1,706,230.00
GIZ	97008	Land.Mang/Cadastre			-	-	-	47,447.00
Gjithsej			169,966.00	796,084.00	1,421,699.00	471,433.00	380,295.00	1,753,677.00

Tabela 6. Të hyrat nga donatorët




Figura 3. Të hyrat nga donatorët 2013-2018

Nga figura 3 shihet që shuma më e madhe e donacioneve ka qenë në vitin 2013, ku më pas ka pasur një rënie në vitin 2014 dhe 2015, ndërsa prapë një rritje të të hyrave nga donatorët në vitin 2016. Në vitin 2017 dhe 2018 kemi pasur prapë një rënie.

Nga tabela 6 shihet që AKK ka të hyra edhe nga huamarrja, ku shuma më e madhe e mjeteve kanë qenë në vitin 2013 dhe 2014, më pas në vitin 2015 dhe më pak në vitin 2016.

Përshkrimi	2018 €	2017 €	2016 €	2015 -1 €	2014 -2 €	2013 €
Banka Botërore		-	509,000.00	1,107,332.00	1,434,977.00	1,222,310.00
Gjithsej		-	509,000.00	1,107,332.00	1,434,977.00	1,222,310.00

Tabela 7. Të hyrat nga huamarrja

9.1.5. Mundësitë (opcionet) e financimit në të ardhmen

Një analizë më detajisht e kemi paraqitur në aneksin 2.

Në bazë të dhënave të fundit që kemi pranuar nga 15 ZKK (Drejtori të Komunave) për paga, mallra dhe shërbime dhe komunal, në vitin 2019 kanë shpenzuar 1,000,265.97 €, ndërsa kanë realizuar të hyra prej 1,596,935.61 €.

<i>Planifikimi dhe realizimi i Buxheti për vitin 2019 për 15 ZKK</i>			
<i>Nr.</i>	<i>Përshkrimi</i>	<i>Planifikimi 2019 (€)</i>	<i>Realizimi 2019 (€)</i>
1	Paga dhe mëditje	1,049,778.11 €	875,698.34 €
2	Mallra dhe shërbime	129,990.00 €	94,088.69 €
3	Investime Kapitale	1,610,000.00 €	949,609.93 €
4	Shpenzime komunale	45,700.00 €	30,478.94 €
5	Të hyrat nga Kadastri	1,533,724.26 €	1,596,935.61 €

Tabela 8. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2019 nga 15 ZKK

Për situatën në të ardhmen, ekzistojnë dy mundësi (opsione) të përgjithshme për financim të sektorit kadastral:

- Mbajtja e principeve ekzistuese të financimit (financim nga buxheti qeveritar) apo
- Financimi miks (nga Qeveria dhe të hyrat vetanake)

Në bazë të analizave që i kemi realizuar nga të dhënat që kemi pasur në dispozicion mundësia më e mirë dhe më e pranueshme nëse kalohet në organizimin vertikal është që AKK të ketë një buxhet miks ku pagat do të mbuloheshin nga Granti Qeveritar, ndërsa, kodet tjera të shpenzimeve të mbuloheshin nga të hyrat vetanake. Në rast që AKK nuk ka mjete të mjaftueshme nga të hyrat vetanake për investimet kapitale, për projektet me interes shtetëror do të duhej që të ndahen nga klauzola e investimeve dhe të evidentohen sipas projekteve.

- Financimi nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës

Financimi i investimeve kapitale në të kaluarën është bërë nga: Granti Qeveritar, Dontarorët dhe huamarrja - Projekti RECAP, ndërsa tani financimi i investimeve kapitale është kryesisht nga huamarrja përkatësisht projekti REGIP.

Mirëpo, me kalimin e organizimit vertikal do të shtoheshin edhe 38 ZKK, dhe konsiderojmë që është një barrë e madhe për të ardhmen për buxhetin e Kosovës dhe kur kemi parasyshë që pas tri viteve do të përfundojë projekti REGIP.

- Të hyrat e parashikuara

Me aprovimin e UA dhe ndryshimit të tarifave do të rriten edhe të hyrat vetanake, kur i shtojmë edhe shërbimet të cilat i kryejnë ZKK-të do të rriten të hyrat vetanake, mirëpo do të rriten edhe shpenzimet. Në bazë të hyrave vetanake mund të mbulohen vetëm rreth 80% të shpenzimeve.


10. STATISTIKAT

10.1. STATISTIKA NGA SIKTK

Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Zyrat Kadastrale Komunale në kuadër të veprimtarisë së vetë biznesore për tri vitet e fundit ka realizuar transaksione të shumta, duke përmbyllur vitet paraprake me një numër të konsiderueshëm të rasteve. Viti 2019 për dallim me vitet tjera ka qenë me numrin më të madh të rasteve të realizuara siq edhe shihet nga tabela dhe grafikoni.

Treguesit kryesorë të performancës do të zhvillohen në vazhdimësi për të mbështetur Planin e Strategjik dhe Planin e Biznesit dhe të Veprimit, i cili do të azhurnohet në përputhje me rrethanat.


Numri i transaksioneve sipas viteve	
Viti	Raste
2017	64423
2018	64897
2019	67537



Numri më i madh i lëndëve të regjistruara në SIKTK, nga ZKK-të dhe AKK-ja janë llojet si: shitblerja, trashëgimia, vendimet gjyqësore dhe hipoteka.


Transaksionet sipas llojeve	Raste		
Viti	2017	2018	2019
Shitblerjet	16497	18029	17594
Trashëgimi	6613	7024	5196
Vendime gjyqësore	742	846	817
Hipotekë	3621	3651	3421

Nga tabela dhe grafikoni shihet që numri më i madh i rasteve të realizuara është nga shitjblerjet, më pas nga trashëgimia dhe hipoteka dhe me më së paku raste janë vendimet gjyqësore.



Korigjimi i parcelave sipas viteve është një tjetër shërbim që ka e kryer AKK-ja dhe ZKK-të, duke pasur një dallim të madh mes vitit 2019 dhe viteve 2018 e 2017.

Korigjimet e parcelave sipas viteve	
Viti	Rastet
2017	3631
2018	3821
2019	6043




Sa i përket lëndëve të papërfunduara e të cilat janë rexhistruar në sistem kemi një rritje nga viti në vit siç shihet nga tabela dhe grafikoni.

Lëndët e papërfunduara të cilat janë regjistruar në sistem

Viti	Rastet
2017	194
2018	1903
2019	2160

Lëndët e papërfunduara të cilat janë regjistruar në sistem




Në vitin 2017 janë vetëm 194 raste, pastaj kemi një rritje të madhe në vitin 2018 me 1903 raste dhe për dallim nga viti 2018 në vitin 2019 kemi gjithashtu rritje 2160 raste.

Republika e Kosovës ka bërë një progres të madh në rangimin e saj në raportin e të bërit biznes të Bankës Botërore për komponentën e regjistrimit të pronës së paluajtshme, ku shihen arritjet nga vendi i 76 në vitin 2013, në vendin 37-të në vitin 2020, e që është një sukses i dukshëm për Agjencinë Kadastrale të Kosovës, me synim për reforma të mëtutjeshme dhe rezultate edhe më të mira në të ardhmen e afërt.

Regjistrimi i Pronës
(Doing Business)

Nr.	Viti	Rangimi i Kosovës
1	2013	76
2	2014	58
3	2015	34
4	2016	32
5	2017	33
6	2018	34
7	2019	37
8	2020	37

DB – Rangimi i Kosovës për regjistrimin e pronës




10.1. STATISTIKA NGA RIK DHE KN

Rindërtimi i Informacioneve Kadastrale (RIK) ka filluar me implementim që nga viti 2005, kurse Kadastri i Ndërtesave ka filluar që nga viti 2006. Deri më tani:

- Janë rindërtuar 175 Zona Kadastrale nga 1305 sa janë në Kosovë. Paraprakisht rreth 400 Zona Kadastrale janë përcaktuar si prioritet për tu rindërtuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.
- Është përfunduar Kadastri i Ndërtesave (KN) (ndërtesat kolektive, banesat, garazhet dhe lokalet afariste në këto ndërtesa) në 30 qytete nga 35 sa janë në vend.

Në hartën e mëposhtme është pasqyruar shtrirja gjeografike e Zonave Kadastrale të rindërtuara në faza të ndryshme gjatë periudhës 2005-2019



11. PËRMBLEDHJE

Plani Strategjik 2021-2025 dhe Plani i Biznesit / Plani i Veprimet 2021-2023+, paraqesin një strategji githëpërfshirëse të zhvillimit të AKK-së si autoriteti qendror për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave kadastrale, për mirëmbajtjen e regjistrave pronësorë, për hartografi dhe GIS, për sistemin e unifikuar të adresave, për infrastrukturën kombëtare të informacioneve hapësinore (IKIH), dhe kompetencat të tjera që iu janë dhënë me Ligj. Gjithsesi dokumenti ka për synim identifikimin, vlerësimin dhe projeksionet e zhvillimit të kadastrit për të arritë realizimin e synimeve të cilat Agjencinë Kadastrale të Kosovës e identifikojnë si organizatë e strukturuar dhe funksionale që është kompetente për ti zbatuar standardet e parapara në direktivat Evropiane, por edhe kompetente për ti dhënë shërbime të gjithë shfrytëzuesve në funksion të zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Plani Strategjik identifikon nevojën për një ndryshim kompetencash e përgjegjësiwe ligjore, të rekomanduar edhe nga disa strategji të hartuara nga institucione kompetente si që është Ministria e Drejtësisë me përkrahje të USAID-it dhe organizata tjera vendore përfshi edhe vetë Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

Funksionimi i Agjencisë Kadastrale si një Autoritet i vetëm unik në menaxhimin dhe zhvillimin e kadastrit në Kosovë mbështetet edhe nga institucione të rëndësishme ndërkombëtare, dhe praktikave të shteteve Evropiane dhe të rajonit. Arritja e këtij synimi kërkon ndryshime në legjislacion si që është Ligji për Kadastrin dhe Ligji për Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH). Këto dy ligje tani janë të draftuara, duke kaluar nëpër një proces diskutimi dhe shqyrtimi, në pjesëmarrje të ekspertëve të fushave dhe grupeve të interesit. Në bazë të analizave gjatë hartimit të këtij dokumenti, kjo çështje është një çështje

parësorë për realizimin e synimeve të Qeverisë së Kosovës, për një siguri të pronave, regjistrim të titujve pronësor, zhvillim të tregut të pronave dhe zhvillim ekonomik të Kosovës.

Zhvillimi i mëtutjeshëm i Sistemit të Informacioneve Kadastrale të Tokës në Kosovë - SIKTK, është një prioritet i përshkruar me një kujdesje të veçantë, duke marrë në konsideratë përvojat evropiane dhe të rajonit.. Regjistrimi sistematik i pronave është një proces që krijon avantazhe të tjera shfrytëzuesve të cilët janë pjesë e zhvillimit ekonomik të Kosovës. Pjesë mbështetëse gjithsesi e paraparë në këtë plan biznesi është zgjerimi i infrastrukturës së teknologjisë informative dhe infrastrukturës gjeohapësinore.

Implementimi dhe avansimi i strategjisë për rritjen e cilësisë së të dhënave në SIKTK, është pjesë më e theksuar e Planit të Biznesit. Gjithsesi, korrektimi i të dhënave në SIKTK, zhvillimi i gjeoportalit të ri shtetëror, finalizimi i sistemit të adresave, zhvillimi i mëtutjeshëm i SIKTK me module të reja, janë disa prej objektivave kryesore operacionale.

Gjithashtu arkivi digjital i dokumentave të vjetra, intensifikon nevojën e vazhdimit të skanimit të dokumenteve kadastrale të cilat gjenden në hapësirat e ZKK-ve. Përgjegjësitë e Agjencisë Kadastrale si një autoritet i vetëm edhe për menaxhimin e të dhënave, krijon nevojën e kolektimit të dokumenteve edhe nga institucionet e tjera përfshi këtu edhe institucionin e Arkivave.

Kjo Strategji dhe Plan i Biznesit, gjithsesi është një strategji e mirë e zhvillimit të AKK-së dhe kadastrit në Kosovë. Është i analizuar sa i përket aspektit financiar, dhe varianteve të financimit. Gjithashtu, garantohet për secilën variant funksionimi normal i AKK-së. Janë marrë në konsideratë edhe projeksionet e AKK-së lidhur me disa projekte të cilat gjithsesi do të duhej të ishin pjesë e strategjisë qoftë

edhe nga buxheti i Kosovës, por që këto projeksione kanë paraparë një mundësi buxhetimi nga huamarrja.

Plani Strategjik ka bërë edhe analiza dhe projeksione të strukturës organizative, numrit të punëtorëve dhe përcaktimet themelore të veprimtarisë së tyre, prandaj zhvillimi burimeve njerëzore është pjesë e përkushtimit të këtij dokumenti, rritja e numrit të punëtorve, trajnimi i stafit janë pjesë parësore e funksionimit të organizatës.

Plani Strategjik 2021-2025 dhe Plani i Biznesit dhe i Veprimit 2021-2023+, shtjellojnë të gjitha aktivitetet e AKK-së; të parapara të implementohen në periudhën e ardhshme 5 vjeçare, të parapara në kuadër të katër objektivave strategjikë dhe të detajizuara në 23 objektiva operacional që dalin nga objektivat strategjik (*shih dokumentin Plani i Biznesit dhe i Veprimit 2021-2023+*).

Ky Plan Strategjik krijon mundësi të hartimit apo plotësimit të strategjive të veçanta e cila i jep epitetin e një plani dinamik të veprimit të AKK-së sidomos në fushën e kadastrit dhe të IT-së.

SHTOJCA 1:

1. ANALIZIMI I BUXHETIT TË AKK-SË DHE ZKK-VE

Në kuadër të projektit draftimi i Planit të biznesit 2021-2025 për Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) kemi bërë një analizë të të ardhurave, kostos operative dhe përmbledhja e investimeve në AKK dhe ZKK.

Para se të bëjmë përshkrimin se çka kemi përfshirë në këtë analizë deri në draftin e parë duhet që të përgjigjemi në disa pyetje pasi që jemi në një situatë ku kemi një ligj aktual për kadastrin dhe kemi edhe projektligjin e ri për kadastrin i cili pritët të shkoj në Kuvendin e Kosovës.

Në kuadër të projektligjit të ri pritët që Zyrat Kadastrale Komunale (ZKK) të hyjnë në kuadër të AKK-së. Kjo na shkakton një reformë të madhe pasi që nga analizimi i të punësuarve nëpër ZKK numri i tyre është shumë i madh.

Në kuadër të këtij ndryshimit të Ligjin për Kadastër, parashihet menaxhimi i ZKK-ve, ku lindin disa pyetje, të cilave duhet që tu përgjigjemi në draftimin e biznes planit 2021-2025:

- Cili do të jetë ndikimi i një riorganizimi të ri sa i përket numrit të stafit përkatës, nivelin e edukimit dhe aftësive profesionale të tyre;
- Cili do të jetë ndikimi i Udhëzimeve të reja në riorganizimin e stafit aktual në ZKK, për faktin që tani nuk do të kryejnë punë të terrenit sipas kërkesave të palëve, por edhe për faktin që niveli akademik i tyre është kryesisht i nivelit të mesëm;

- A ka një strategji mbështetëse emergjente të ndihmohen ZKK-të që gjeodetët të cilët deri tani kanë kry punë të terrenit sipas kërkesave të palëve, të jenë të organizuar në punë të tjera;
- A është bërë ndonjë vlerësim i nivelit të grumbullimit të mjeteve nga produktet kadastrale të AKK-së, dhe ZKK-ve pas miratimit të Udhëzimeve Administrative;
- A keni ndonjë vlerësim të Qeverisë respektivisht Ministrisë së Pushtetit Lokal, Ministrisë së Financave për mundësinë që Qeveria e re respektivisht Parlamenti i Republikës së Kosovës të mundësojë ndryshimet sa i përket organizimit vertikal;
- A planifikohet që Agjencia Kadastrale të krijohet si Agjenci Jo buxhetore (duke nënkuptuar buxhetin shtetëror që korrespondon me nevojat e shtetit dhe të hyrat nga produktet dhe shërbimet për klient të tjerë);
- Si do të veprohet me integrimet në aspektin praktik për 4 komunat në pjesën veriut të Kosovës;
- Cili do të jetë roli i organizatave të Gjeodetëve – Odës respektivisht Shoqatës së Gjeodetëve.

Të gjitha këtyre pyetjeve ju kemi përgjigjur së bashku me ndihmën e menaxhmentit të AKK-së dhe ekspertëve të konsorciumit tonë, duke dhënë rekomandime dhe duke planifikuar një të ardhme të qëndrueshme për AKK-në.

Në këtë raport fillimisht kemi analizuar buxhetin e 5 viteve të fundit duke analizuar të gjitha të hyrat dhe shpenzimet të cilat janë realizuar gjatë këtyre viteve. Kemi nxjerrë një mesatare për çdo vit të të hyrave dhe gjithashtu të shpenzimeve. Duke u bazuar në atë mesatare të analizave kemi bërë parashikimin 5 vjeçar për të hyrat dhe shpenzimet e AKK. Vlen të theksohet që kemi analizuar dhe realizuar dy variante.

Variantin sipas ligjit aktual duke mos përfshirë ZKK-të dhe kemi analizuar sipas projektligjit të ri ku përfshihen edhe ZKK-të.

Në bazë të analizave financiare AKK sipas ligjit aktual nuk ka qëndrueshmëri financiare për të mbuluar të gjitha shpenzimet. Mirëpo, nëse fillon zbatimi i organizimit vertikal duke futur ZKK nën menaxhimin e AKK atëherë kemi një qëndrueshmëri por jo-stabile pasi që Shpenzimet dhe të hyrat vetanake janë në kufirin kritik.

1.1. ANALIZA E TË ARDHURAVE, KOSTOS OPERATIVE DHE PËRMBLEDHJA E INVESTIMEVE NË AKK DHE ZKK

Në bazë të Ligjit Nr. 04/-L-013, Neni IV, AKK-ja, vepron si Agjenci Ekzekutive në kuadër të Qeverisë së Kosovës, gjegjësisht të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe me të udhëheq Kryeshefi Ekzekutiv i AKK-së, i cili zgjidhet në pajtueshmëri me rregullat në fuqi për emërimin e nëpunësve të lartë civilë të shërbimit civil. Kryeshefi i AKK-së i përgjigjet Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit. Agjencia Kadastrale e Kosovës është përgjegjëse për Kadastër dhe ka kompetenca për nxjerrjen e udhëzuesve lidhur me të gjitha veprimtaritë kadastrale, për administrimin e sistemit shtetëror kompjuterik i cili grumbullon, përpunon dhe shpërndan të dhënat kadastrale. Si institucion i nivelit qendror, AKK është përgjegjëse për certifikimin e personave në ZKK-në për kryerjen e matjeve kadastrale dhe për licencimin e kompanive dhe gjeodetëve për kryerjen e matjeve kadastrale.

Shpenzimet për ngritjen dhe rindërtimin e Kadastrit, mbulohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe nga të hyrat vetanake në pajtim me ligjin në fuqi për menaxhimin e financave dhe përgjegjësie.

Në bazë të projektligjit të ri i cili është në procedurë, të hyrat vetanake sigurohen nga aktiviteti i AKK-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Këto të hyra vetanake, mund të shfrytëzohen edhe për: mbulimin e harxhimeve për punën rrjedhëse dhe zhvillim; të ardhurat personale, mallra dhe shërbime, komunalitë dhe investime kapitale; dhe për trajnim dhe aftësime profesionale. Tarifat e shpenzimeve për nxjerrjen e të dhënave nga kadastri bien në barrë të kërkuesit të të dhënave, në lartësi të caktuar me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria. Niveli i tarifave për produktet dhe shërbimet kadastrale dhe shërbimet e regjistrimit të pronave në regjistrin e të drejtave në pronën e paluajtshme përcaktohen me aktin nënligjor, të nxjerrë nga Ministria me propozimin e AKK-së.

1.2. ANALIZË E BUXHETIT PARAPRAK TË AKK-SË

Ne kemi analizuar buxhetin për 5 vitet e fundit 2015-2019 dhe në bazë të analizave tona shihet që buxheti nga viti në vit ka pasur një rritje të buxhetit në total.

	2015	2016	2017	2018	2019
Paga dhe mëditje	347,727.00	380,709.00	362,005.00	367,801.00	380,190.01
Mallra dhe shërbime	65,000.00	68,254.00	110,000.00	110,000.00	268,000.00
Komunali	9,350.00	9,350.00	9,350.00	9,350.00	9,350.00
Kapitale	487,500.00	721,500.00	1,157,000.00	1,384,000.00	2,162,000.00
Total	909,577.00	1,179,813.00	1,638,355.00	1,871,151.00	2,819,540.01

Tabela 9. Buxheti i AKK-së për 5 vite (të shprehura në euro)




Figura 4. Buxheti i AKK-së për 5 vitet e fundit

Nëse analizojmë sipas pozicioneve, vetëm pozicioni paga dhe mëditje në vitin 2017 ka pasur një zvogëlim të buxhetit prej 5%. Ndërsa, të gjitha pozicionet tjera kanë pasur rritje, nga viti në vit.

	2016	2017	2018	2019
Paga dhe mëditje	9%	5%	2%	3%
Mallra dhe shërbime	5%	38%	0%	59%
Komunali	0%	0%	0%	0%
Kapitale	32%	38%	16%	36%
Total	23%	28%	12%	34%

Tabela 10. Përqindja e rritjes sipas viteve – nga viti në vit

Nga figura 4 shihet që pozicioni i pagave dhe mëditje përveç zvogëlimit në vitin 2017 ka pasur një rritje të vogël prej 2% mesatarisht.

Mallra dhe shërbime ka pasur një rritje mesatare prej 25% për 5 vite. Vërehet që në vitin 2017 dhe 2018 buxheti ka qenë i njëjtë, ndërkaq në vitin 2019 ka pasur një rritje prej 59% në krahasim me vitin 2018.

Komunalit nuk kanë pasur ndonjë lëvizje të trendit. Ndërsa, buxheti për kapitale ka pasur një trend të rritjes mesatare prej 31%.




Figura 5. Trendi i rritjes nga viti në vit i buxhetit të AKK-së

Si përfundim, buxheti i paraparë për AKK në përgjithësi ka pasur një rritje mesatare për 5 vite prej 24%, dhe kjo rritje mund të merret si bazë për planifikimin e mëtutjeshëm për 5 vitet e ardhshme.

1.3. ANALIZIMI I SHPENZIMEVE DHE TË HYRAVE SIPAS VITEVE

Analizimi i shpenzimeve dhe të hyrave buxhetore është bërë në bazë të pasqyrave financiare sipas viteve të dorëzuara nga AKK.

1.4. ZYRAT KADASTRALE KOMUNALE

ZKK-ja është organ komunal dhe është përgjegjëse për funksionimin e kadastrit. ZKK-ja kryen të gjitha aktivitetet kadastrale në përputhje me kompetencat e deleguara nga niveli qendror, dispozitat e këtij ligji dhe udhëzimet administrative të nxjerra nga AKK-ja dhe Ministria. Të gjitha aktivitetet e ZKK-së realizohen dhe pasqyrohen në bazën qendrore të të dhënave të AKK-së.

2. PARASHIKIMI I TË HYRAVE PËR ZKK

Ne kemi hulumtuar për 38 Komunitet e Kosovës dhe kemi analizuar numrin e punëtorëve, planifikimin e të hyrave vetanake dhe planifikimin e shpenzimeve.

Fillimisht po paraqesim një tabelë për ZKK-të të cilën e kemi pranuar nga AKK-ja që pasqyron të dhënat për vitin 2018.

Nr.	Komunitet	Nr. Stat	Pagat	Të hyrat 2018
1	Deçan	6	38,279.04	46,000.00
2	Dragash	8	43,367.64	35,531.00
3	Ferizaj	12	68,990.52	238,151.75
4	Fushë Kosovë	9	55,736.16	139,000.00
5	Glllogovc	10	62,632.08	46,060.50
6	Graçanicë	5	32,001.00	112,071.00
7	Gjakovë	17	90,911.16	165,599.00
8	Gjilan	19	115,098.84	220,000.00
9	Hani i Elezit	4	28,354.56	21,195.00
10	Istog	8	47,153.64	66,313.00
11	Junik	7	47,236.80	10,267.00
12	Kamenicë	7	41,476.68	
13	Kaçanik	7	44,406.60	
14	Klinë	10	60,963.72	
15	Klllokot	4	26,262.96	
16	Leposaviq	5	26,538.00	
17	Lipjan	9	49,530.00	115,226.00
18	Malishevë	9	49,029.24	41,189.00
19	Mamushë	4	26,057.04	
20	Mitrovicë e Veriut	4	24,571.32	
21	Mitrovicë	16	85,565.16	119,121.38
22	Novobërdë	5	26,437.68	
23	Obiliq	6	35,914.44	77,599.00
24	Partesh	5	27,667.20	
25	Pejë	17	92,250.72	310,826.00
26	Podujevë	19	107,550.00	148,807.00
27	Prishtinë	28	155,894.40	612,234.00
28	Prizren	18	104,208.36	220,000.00
29	Rahovec	10	47,104.08	76,644.00
30	Ranilluk	6	43,850.00	
31	Skenderaj	11	59,391.84	57,404.00

32	Suharekë	9	19,847.04	96,009.00
33	Shtërpce	5	30,695.88	36,366.00
34	Shtime	7	58,175.76	50,000.00
35	Viti	9	60,571.32	88,000.00
36	Vushtrri	11	53,133.12	120,000.00
37	Zubin Potok	11	15,000.00	
38	Zveçan	4	20,266.00	
Totali:		361	2,022,120.00	3,269,613.63

Tabela 11. Numri i punëtorëve, shpenzimet për paga dhe të hyrat për vitin 2018 në ZKK-të

Në bazë të kësaj tabelës 11 ne mund të konkludojmë që në rast se ZKK-të do të ishin në kuadër të AKK-së dhe do të menaxhonin me stafin dhe buxhetin, do të kishim një qëndrueshmëri financiare nga të hyrat vetanake duke i mbuluar shpenzimet për paga dhe mallra e shërbime. Kjo pa e bërë një analizë për reduktimin e stafit, mirëpo vetëm nga të hyrat dhe numrin aktual të punëtorëve.

Ne kemi analizuar gjithashtu 38 Komunitet e Kosovës, përkatësisht drejtoritë komunale të cilat merren me kadastër dhe gjeodezi, ku për disa kemi gjetur të dhëna ndërsa për të tjerat jo.

Nga 38 komuna kemi analizuar kornizat afatmesme të shpenzimeve 2020-2023 të 23 Komunave, ku prej tyre 13 kanë informacione të plota mbi të cilat do të mund të bëjmë parashikimin e të hyrave dhe shpenzimeve për 5 vitet e ardhshme në kuadër të planit të biznesit të AKK-së 2021-2025.

Nr.	Komuna	Punëtorë	2020	2021	2022
1	Ferizaj	21	134,932.78 €		
2	Glogoc	12	77,034.00 €	77,034.00 €	77,034.00 €
3	Gjakovë	19	120,760.00 €	120,760.00 €	120,760.00 €
4	Gjilan	26	173,000.00 €	182,500.00 €	190,300.00 €
5	Hani Elezit	8	58,299.00 €	58,299.00 €	58,299.00 €
6	Istog	10	75,000.00 €	75,000.00 €	75,000.00 €
7	Junik				
8	Kaçanik				
9	Kamenicë	10	67,000.00 €		
10	Klinë	11	85,716.00 €	90,404.00 €	94,299.00 €
11	Lipjan	10	66,101.00 €	66,101.00 €	66,101.00 €
12	Malishevë	9	65,885.00 €	65,885.00 €	65,885.00 €
13	Mamushë	6	37,710.00 €	35,765.00 €	35,765.00 €
14	Mitrovica e Jugut	19	116,900.00 €	117,500.00 €	118,100.00 €
15	Pejë	22	144,876.00 €		
16	Podujevë	19	133,416.00 €	133,416.00 €	133,416.00 €
17	Prishtinë	30	220,000.00 €	235,495.00 €	250,000.00 €
18	Prizren	19	143,295.00 €		
19	Rahovec				
20	Suharekë	14	80,000.00 €	80,000.00 €	80,000.00 €
21	Shtime		67,427.00 €	67,427.00 €	67,427.00 €
22	Viti	9	51,554.00 €	54,493.00 €	55,563.00 €
23	Vushtrri	14	85,052.00 €	87,487.00 €	87,924.00 €

Tabela 12. Planifikimi për drejtoritë e kadastrit nëpër komuna për shpenzimet për paga dhe mëditje sipas KAB 2020-2022

Planifikimi i të hyrave vetanake duke ofruar shërbime gjeodezike dhe kadastrale nëpër komunitat e Kosovës është bërë në kuadër të KAB 2020-2023. Kemi analizuar gjithsej 16 komuna të cilat kanë planifikuar të hyra nga shërbimet gjeodezike.

Nr.	Komuna	2020	2021	2022
1	Ferizaj	250,868.00 €	250,868.00 €	250,868.00 €
2	Glllogoc	75,000.00 €	80,000.00 €	85,000.00 €
3	Gjakovë	170,000.00 €	183,490.00 €	197,009.00 €
4	Gjilan	230,000.00 €	230,000.00 €	230,000.00 €
5	Istog	85,000.00 €	85,000.00 €	85,000.00 €
6	Junik	9,000.00 €	9,200.00 €	9,400.00 €
7	Kaçanik	12,000.00 €	13,000.00 €	14,000.00 €
8	Kamenicë	9,000.00 €	9,000.00 €	9,000.00 €
9	Klinë	900.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €
10	Lipjan	40,000.00 €	40,000.00 €	40,000.00 €
11	Mitrovica e Jugut	125,000.00 €	125,000.00 €	125,000.00 €
12	Pejë	150,000.00 €	400,000.00 €	500,000.00 €
13	Prishtinë	700,000.00 €	705,000.00 €	710,000.00 €
14	Shtime	14,500.00 €	9,350.00 €	10,000.00 €
15	Viti	80,200.00 €	89,500.00 €	89,500.00 €
16	Vushtrri	70,000.00 €	73,000.00 €	75,000.00 €

Tabela 13. Planifikimi i të hyrave vetanake në kuadër të KAB 2020-2022 të komunave

Nëse i shtojmë edhe dy vite të tjera duke u bazuar në rritjen të cilën e kanë parashikuar komunat i kemi paraqitur në tabelën 11.

Nr.	Komuna	2020	2021	2022	2023	2024
1	Glllogoc	75,000.00 €	80,000.00 €	85,000.00 €	90,000.00 €	95,000.00 €
2	Ferizaj	250,868.00 €	250,868.00 €	250,868.00 €	250,000.00 €	250,000.00 €
3	Gjakovë	170,000.00 €	183,490.00 €	197,009.00 €	198,979.09 €	200,000.00 €
4	Gjilan	230,000.00 €	230,000.00 €	230,000.00 €	230,000.00 €	230,000.00 €
5	Istog	85,000.00 €	85,000.00 €	85,000.00 €	85,000.00 €	85,000.00 €
6	Junik	9,000.00 €	9,200.00 €	9,400.00 €	9,600.00 €	9,800.00 €
7	Kaçanik	12,000.00 €	13,000.00 €	14,000.00 €	14,000.00 €	14,000.00 €
8	Kamenicë	9,000.00 €	9,000.00 €	9,000.00 €	9,000.00 €	9,000.00 €
9	Klinë	900.00 €	10,000.00 €	10,000.00 €	10,000.00 €	10,000.00 €
10	Lipjan	40,000.00 €	40,000.00 €	40,000.00 €	40,000.00 €	40,000.00 €
11	Mitrovica e Jugut	125,000.00 €	125,000.00 €	125,000.00 €	125,000.00 €	125,000.00 €
12	Pejë	150,000.00 €	400,000.00 €	500,000.00 €	400,000.00 €	400,000.00 €
13	Prishtinë	700,000.00 €	705,000.00 €	710,000.00 €	715,000.00 €	720,000.00 €
14	Shtime	14,500.00 €	9,350.00 €	10,000.00 €	10,000.00 €	10,000.00 €
15	Viti	80,200.00 €	89,500.00 €	89,500.00 €	89,500.00 €	89,500.00 €
16	Vushtrri	70,000.00 €	73,000.00 €	75,000.00 €	75,000.00 €	75,000.00 €
Gjithsej:		2,021,468.00 €	2,303,408.00 €	2,430,777.00 €	2,342,079.09 €	2,353,300.00 €

Tabela 14. Parashikimi i të hyrave vetanake në ZKK-të 2021-2025

3. PARASHIKIMI I BUXHETIT TË AKK-SË PËR 5 VITET E ARDHSHEME 2020-2024

Parashikimi financiar i planit të biznesit nuk duhet të vështrohet si kalkulim i saktë i buxhetit. Ky është një pasqyrim i përafërt i përgjithësuar i fondeve që nevojiten për të kryer aktivitetet e prezantuara, që ka për qëllim të nis diskutimet për principet e financimit të AKK-së.

Siç është rasti me shumicën e parashikimeve, kalkulimet janë më të sakta në periudhën afatshkurtër dhe bëhen më pak të parashikueshme në periudhën afatgjatë. Kjo është një prej arsyeve pse është e nevojshme të azhurnohen planet për çdo vit si një “parashikim i rrjedhshëm”.

Parashikimi jonë është bazuar në trendin e rritjes së shpenzimeve dhe të hyrave për 5 vitet e fundit ku është marrë mesatarja e rritjes për 5 vite dhe është kalkuluar parashikimi.

Përshkrimi	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Të hyrat						
Të hyrat tatimore						
Të hyrat jo tatimore		97,332.00	104,145.24	111,435.41	119,235.89	127,582.40
Donacionet		-	-	-	-	-
Të hyrat e dedikuara						
Grantet e përcaktuara të donatorëve						
Huamarrjet		3,700,000.00	3,700,000.00	3,700,000.00	3,700,000.00	
Tjera						
Gjithsej të hyrat	-	3,797,332.00	3,804,145.24	3,811,435.41	3,819,235.89	127,582.40
Shpenzimet						
Paga dhe mëditje	380,190.01	380,380.11	380,570.30	380,760.58	380,950.96	381,141.44
Mallra dhe shërbime	268,000.00	110,000.00	110,000.00	136,400.00	169,136.00	209,728.64
Shpenzime komunale	9,350.00	9,350.00	9,350.00	9,350.00	9,350.00	9,350.00
Shpenzime kapitale	2,162,000.00	1,047,795.89	830,230.70	1,029,486.07	1,276,562.73	1,582,937.79
Kthim i huamarrjeve						
Tjerat						
Gjithsej Shpenzimet	2,819,540.01	1,547,526.00	1,330,151.00	1,555,996.65	1,835,999.69	2,183,157.86
Buxheti total	2,819,540.01	5,344,858.00	5,134,296.24	5,367,432.06	5,655,235.58	2,310,740.26

Tabela 15. Parashikimi i buxhetit për 5 vitet e ardhshme për AKK-në (të shprehura në euro)

Në tabelën 12 është paraqitur në kolonën e parë është paraqitur buxheti i planifikuar sipas Ligjit për Buxhet 2019, ku e kemi marrë si bazë për të kalkuluar parashikimin e buxhetit për 5 vitet e ardhshme 2021-2025. Në vitin 2020 kemi paraparë të hyra jo tatimore ku i kemi marrë duke u bazuar në të pasqyrat financiare të vitit 2018 dhe i kemi kalkuluar me një rritje për çdo vit nga 7%.

Te shpenzimet kapitale jemi bazuar te vlerësimi i BK 2019 ku totali për vitin 2020 është 1,547,526 Euro. Ndërsa, për vitin 2021 vlerësimi është në total prej 1,330,151 Euro.

Te paga dhe mëditja kemi kalkuluar në bazë të ligjit aktual për rritje ku i kemi shtuar për çdo vit nga 0.05%.

Sa i përket të hyrave nga donacionet në bazë të informacioneve nga AKK, kemi marrëveshje bilaterale (donacion) nga Qeveria Norvegjeze, janar 2018-tetor 2020 dhe marrëveshje regjionale për 8 Agjenci të Kadastrit përfituese (donacion) nga Qeveria Holandeze, shkurt 2020 - dhjetor 2022.

Vlen të theksohet që parashikimi në tabelën 12 është bërë në kuadër të ligjit aktual dhe nuk përfshinë në vete edhe buxhetin e ZKK-ve.

4. PARASHIKIMI I BUXHETIT 2020-2024

SË BASHKU ME ZKK-TË

Parashikimi në tabelën 13 është bërë në rast të hyrjes në fuqi të projektligjit për kadastrin. Për dallim nga tabela 12 në këtë parashikim kemi paraparë të hyrat nga ZKK-të ku për bazë kemi marrë vitin 2018 dhe i kemi llogaritur me 7% rritje nga viti në vit.

Përshkrimi	2020	2021	2022	2023	2024
Të hyrat					
Të hyrat tatimore					
Të hyrat jo tatimore	97,332.00	104,145.24	111,435.41	119,235.89	127,582.40
Donacionet					
Të hyrat e dedikuara					
Grantet e përcaktuara të donatorve					
Huamarrjet	3,700,000.00	3,700,000.00	3,700,000.00	3,700,000.00	
Të hyrat nga ZKK	3,269,613.63	3,498,486.58	3,743,380.64	4,005,417.29	4,285,796.50
Gjithsej të hyrat	7,066,945.63	7,302,631.82	7,554,816.05	7,824,653.18	4,413,378.90
Shpenzimet					
Paga dhe mëditje	2,402,500.11	2,403,701.36	2,404,903.21	2,406,105.66	2,407,308.71
Mallra dhe shërbime	136,400.00	136,400.00	136,400.00	136,400.00	136,400.00
Shpenzime komunale	355,300.00	355,300.00	355,300.00	355,300.00	355,300.00
Shpenzime kapitale	1,047,795.89	830,230.70	1,029,486.07	1,276,562.73	1,582,937.79
Kthim i huamarrjeve					
Tjerat					
Gjithsej Shpenzimet	3,941,996.00	3,725,632.06	3,926,089.28	4,174,368.39	4,481,946.50
Buxheti total	11,008,941.63	11,028,263.88	11,480,905.33	11,999,021.56	8,895,325.40

Tabela 16. Parashikimi i buxhetit 2021-2025 duke përfshirë ZKK-të (të shprehura në euro)

Te pozicioni paga dhe mëditje gjithashtu kemi marrë bazë të dhënat e vitit 2018 dhe i kemi rritur për 7% si rritje mesatare e të hyrave që është për çdo vit. I kemi rritur për 24% buxhetin për mallra dhe shërbime dhe komunalit i kemi shumëzuar me 38 ZKK.

Nëse analizojmë qëndrueshmërinë e buxhetit për 2020 – 2024 mund të kolaudojmë që me ligjin aktual AKK nuk ka mundësi që të vetëfinancohet nga të hyrat vetanake pasi që nuk mund ti mbuloj shpenzimet e veta për paga dhe mëditje.




Figura 6. Dallimi në mes të hyrave dhe shpenzimeve të AKK-së 2021-2025

Në figurën 5 janë paraqitur të hyrat vetanake të AKK-së dhe Shpenzimet duke mos i përfshirë shpenzimet kapitale, por vetëm Paga dhe mëditje, komunalit, dhe pozicionin mallra dhe shërbime.

Nëse bëjmë edhe një krahasim në mes të hyrave dhe shpenzimeve duke i përfshirë ZKK-të, do të kemi një situatë më të mirë financiare. Nëse nuk i përfshijmë shpenzimet kapitale atëherë figura 6 na tregon që kemi një qëndrueshmëri financiar. Mirëpo, duhet pasur parasysh për investimet kapitale që të sigurohen nga granti qeveritar apo donatorët.




Figura 7. Krahasimi i të hyrave dhe shpenzimeve të AKK së bashku me ZKK-të por pa i përfshirë investimet kapitale

Në figurën 7 e kemi një situatë më të ndërlikuar, ku shihet që edhe nëse i shtojmë investimet kapitale AKK është në gjendje në bazë të parashikimeve ti mbuloj shpenzimet e veta. Mirëpo, është në kufirin kritik, për të dështuar.




Figura 8. Krahasimi i të hyrave dhe shpenzimeve të AKK së bashku me ZKK-të duke i përfshirë Investimet kapitale

SHTOJCA 2:

REFERENCAT

- Strategjia dhe Plani i Biznesit të AKK-së, 2009 -2013,
- Strategjia dhe Plani i Biznesit të AKK-së, 2013 -2017,
- Strategjia e AKK-së për IT, 2017 – 2021,
- Strategjia e AKK-së për IKIH, 2016 – 2020,
- Project Appraisal Document i projektit RECAP,
- Project Appraisal Document i projektit REGIP,
- Ligji mbi Hipotekat Nr.2002-4,
- Ligji mbi Themelimin e Regjistrit të të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme Nr.2002-5,
- Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për kadastrin Nr. 02 L-96,
- Ligji Nr 04_L-009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2002 5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme,
- Ligji për Kadastër Nr. 04-L/013,
- Ligji Nr. 04/L-071 për sistemin e adresave,
- Ligji për Kadastrin Nr 2003/25 (ligji paraprak).
- Ligji mbi Plotësimet dhe ndryshimet e Ligjit të RDPP 2003-13,
- Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020,

- Udhëzim Administrativ Mmph Nr 08-2019 Për Tarifat E Produkteve Dhe Shërbimeve Të Agjencisë Kadastrale Të Kosovës,
- Udhëzim Administrativ (Mmph) Nr 13-2019 Për Licencimin E Kompanive Gjeodete Dhe Të Gjeodetëve,
- Udhëzim Administrativ Mmph – Nr 09-19 Për Ndarjen E Zonave Kadastrale,
- Udhëzim Administrativ Mmph – Nr 10-19 Për Matjet Kadastrale Për Regjistrim Në Kadastër,
- Udhëzim Administrativ Mmph – Nr 11-19 Për Ndarjen E Ndërtesës Dhe Të Pjesës Së Ndërtesës,
- Udhëzim Administrativ Mmph – Nr 12_19 Për Ndarjen Dhe Regjistrimin E Parcelës,
- Udhëzimi Administrativ Nr.14_2019 Për Caktimin E Emërtimeve Dhe Numërimit Të Adresave Për Zona Të Qarkullimit Publik, Ndërtesa, Shtëpi, Objekte Dhe Parcela Kadastrale Të Lira,
- Udhëzim Administrativ Nr.15_2019 Për Renditjen E Elementeve Të Adresave Dhe Caktimin E Formatit Të Shkronjave, Numrave Dhe Të Tabelave Të Adresave,
- Udhëzim Administrativ Mmph Nr 16 Për Procedurat E Krijimit Dhe Administrimit Të Regjistrimit Komunal Të Adresave Dhe Regjistrimit Shtetëror Të Adresave,
- Udhëzim Administrativ Mmph Nr. 17 Për Krijimin Dhe Administrimin E Listës Alfabetike Për Emërtime, Listës Rezervë Dhe Vendosjen E Tyre Në Regjistrin Komunal Të Adresave,

- Udhëzimi Administrativ Nr.18_2019 Për Vendosjen Fizike Të Tabelave Dhe Adresave Në Zona Të Qarkullimit Publik, Ndërtesa, Shtëpi, Objekte Dhe Parcela Kadastrale Të Lira,
- Udhëzimi Administrativ Mmph-Nr. 18_2015 Për Regjistrimin E Shpronësimit Të Pronës Së Paluajtshme,
- Udhëzimi Administrativ Për Regjistrimin E Pronës Në Emër Të Të Dy Bashkëshortëve,
- Udhëzimi Administrativ Nr 02 2012 Për_Rindërtimin E Kadastrit Dhe Regjistrin Të Të Drejtave Mbi Pronën E Paluajtshme,
- Udhëzimi Administrativ Nr. 03 2012 Për Punën E Komisionit Për Rindërtimin E Kadastrit Dhe Regjistrin Të Të Drejtave Mbi Pronën E Paluajtshme,
- Udhëzimi Administrativ Nr. 04 2012 Për Fushatën E Sensibilizimit Për Publikun Gjatë Rindërtimit Të Kadastrit Dhe Regjistrin Të Të Drejtave Mbi Pronën E Paluajtshme,
- Udhëzimi Administrativ Nr. 08 2014 Për Tarifat E Shërbimeve Për Regjistrimin E Të Drejtave Të Pronës Së Paluajtshme Nga Zyret Kadastrale Komunale,
- Korniza e Punës 2020/01për matje, krijim dhe regjistrim të njësive kadastrale (parcelë, ndërtesë dhe pjesë të ndërtesës),
- Rregullorja mbi Organizimin e Brendshëm të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, 2014,
- Korniza afatmesme e shpenzimeve 2019-2022,

- Raportet e punës së AKK-së për vitet 2017, 2018 dhe 2019 dhe planet e punës së AKK-së për vitet 2019 dhe 2020,
- Raportet e punës së projekteve të publikuara në uebfaqen e AKK-së,
- BE. 2007. Urdhëresa 2007/2/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshilli i datës 14 mars 2007 për krijimin e një infrastrukture për informacionin hapësinorë, Bashkësinë Evropiane (INSPIRE).

